



RAPORT STUDIMOR

PROBLEMET, SJELLJET DHE PRITSHMËRITË TEK NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA NË QYTETIN E ELBASANIT



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME



**RESILIENCE
FUND**
Supporting community
responses to organized crime



RAPORT STUDIMOR

Habitati ku zhvillohet jeta e të rinjve 14-15 vjeçarë në qytetin e Elbasanit; shqetësimet, aspiratat dhe figurat e tyre model



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME



**RESILIENCE
FUND**
Supporting community
responses to organized crime

Ky publikim u realizua nga shoqata “Information Network & Active Citizenship” (INAC) me mbështetjen financiare të “The Resilience Fund” dhe “The Global Initiative Against Transnational Organized Crime”

Shoqata INAC i shpreh mirënjohjen e saj Ministrisë së Arsimit dhe stafit pedagogjik të shkollave 9- vjeçare në qytetin e Elbasanit për mbështetjen e dhënë për pjesëmarrjen e nxënësve në këtë projekt studimor.

INAC falënderon të gjithë nxënësit që u bënë pjesë e këtij studimi dhe ndanë mendimet, përjetimet dhe perceptimet e tyre me çiltërsi dhe sinqeritet.

Projekti studimor “Habitati ku zhvillohet jeta e të rinjve 14-15 vjeçarë në qytetin e Elbasanit: shqetësimet, aspiratat dhe figurat e tyre model” u zhvillua nën menaxhimin e eksperteve studimore, Znj. Alketa Berzani, Znj. Arlinda Shehu dhe Znj. Silvana Xheka, të cilat janë gjithashtu edhe autoret e këtij raporti.

Opinionet e shprehura në këtë dokument përfaqësojnë ato të të rinjve 14-15 vjeçarë në qytetin e Elbasanit dhe interpretimin e autorëve të këtij raporti studimor, ndërkohë që nuk janë domosdoshmërisht përfaqësuese të qëndrimit të INAC, “The Resilience Fund” apo “The Global Initiative Against Transnational Organized Crime”.

Maj 2022, Shqipëri

Përmbajtja

| | |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| KAPITULLI I – RISHIKIM LITERATURE E STUDIMESH TË TJERA..... | 7 |
| 1.1 Parathënie për studimin..... | 7 |
| 1.2 Të dhëna mbi qytetin e Elbasanit dhe të rinjtë | 7 |
| 1.3 Figurat model dhe rëndësia e tyre | 9 |
| KAPITULLI II – METODOLOGJIA | 13 |
| KAPITULLI III – GJETJET STUDIMORE..... | 15 |
| 3.1 Stili i jetesës dhe nevojat e paplotësuara | 15 |
| 3.2 Çështje problematike në jetën e të rinjve | 21 |
| 3.2 Aspiratat dhe synimet drejt së ardhmes | 25 |
| 3.4 Mikro-mjediset që rrethojnë dhe ndikojnë adoleshentët | 28 |
| 3.5 Figurat modelet sipas këndvështrimit të 14-15 vjeçarëve..... | 38 |
| KAPITULLI IV – REKOMANDIME | 47 |
| ANEKSE | 49 |
| ANEKSI A – LISTA E FIGURAVE..... | 49 |
| ANEKSI B – UDHËRRËFYESI PËR FOKUS GRUPET ME DJEM E VAJZA..... | 50 |
| ANEKSI C – PYETËSORI SASIOR ME TË RINJTË E KLASAVE TË 9-TA NË QYTETIN E ELBASANIT..... | 53 |

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shoqata INAC, në kuadër të projektit “Toward a Positive Future”, mbështetur nga “The Resilience Fund” dhe “The Global Initiative Against Transnational Organized Crime”, zhvilloi një studim me fokus të rinjtë e shkollave 9-vjeçare në qytetin e Elbasanit. Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të kuptuarit e faktorëve që ndikojnë tek kjo grupmoshë dhe i frymëzojnë ata për të ardhmen, si dhe të kuptuarit e perceptimeve të tyre mbi figurën model dhe identifikimin e tyre.

Studimi, i vetmi i këtij lloji në vend, ofron një panoramë mbi përjetimet e të rinjve, problematikat që ata hasin dhe nevojat që kanë për shembuj pozitivë e figura model për një zhvillim sa më të shëndetshëm. Ky studim u zbatua përmes një metodologjie të kombinuar gjatë periudhës 23 nëntor 2021 – 2 mars 2022, periudhë gjatë së cilës u realizuan 4 fokus grupe dhe 260 intervista online.

Analiza e gjetjeve studimore nga të dyja këto faza, nxjerr në pah disa gjetje kryesore si më poshtë vijon:

Aktivitetet kryesore të jetës së adoleshentëve të moshës 14-15 vjeçare në qytetin e Elbasanit, zhvillohen primarisht në rrethin familjar ndjekur nga ai shoqëror. Jeta virtuale i mbivendoset realitetit të tyre social, dhe struktura kryesore virtuale ku të rinjtë shpenzojnë kohë janë rrjetet sociale, ndjekur nga nga interneti për lexime, video dhe lojëra elektronike.

Pasione të rëndësishme në jetën e të rinjve janë sportet e ndryshme mbizotërues disi më shumë mes djemve dhe vizatimi, piktura, aktrimi, muzika, gatimi, kujdesi për kafshët, udhëtimet etj. disi më të preferuara mes vajzave. Të dyja gjinitë vlerësojnë se ka diferenca në aktivitetet që kryejnë vajzat dhe djemtë, nisur nga stereotipet gjinore dhe kufizimet shtesë që vajzat kanë në shoqëri dhe familje. Muzika është lajtmotivi i jetës rinore, shoqëruese e përhershme dhe aktiviteti më i preferuar për vajza e djem bashkë.

Televizioni ka një rol relativisht të dobët në jetën e të rinjve pasi shikueshmëria nuk është masive apo e shpeshtë dhe ndikimi i perceptuar në jetën e të rinjve relativisht i ulët. Letërsia, nuk përqafohet rregullisht nga të gjithë dhe besnikët e saj të rregullt janë së shumti vajzat. Feja nga ana tjetër, gjithashtu përqafohet nga një segment i vogël i adoleshentëve, por ka ndjekës më besnik mes djemve që për më tepër raportojnë besim më të lartë tek udhëheqësit fetar.

Të rinjtë e klasave të 9-ta në qytetin e Elbasanit mendojnë se prioritet për të përmirësuar jetën e të rinjve në qytetin e tyre janë, siguria në shkollë dhe rrugë, si edhe kushte në shkollë, duke dëshmuar situatën e rënduar sociale në qytet. Siguria është nevojë bazike, ndaj mungesa e saj nuk lejon lulëzimin e jetës dhe zhvillimit psikosocial të të rinjve. Strukturat policore, instucionet lokale, shkollat dhe kushdo aktor tjetër me influencë dhe përgjegjësi, duhet të tronditet nga këto rezultate. Nxënësit deklarojnë se ka mungesa në aktivitetet kulturore, sociale, si dhe të hapësirave për të praktikuar sport, por gjithsesi këto nevoja pozicionohen si dytësore. Piramida e nevojave na vjen në ndihmë për të kuptuar sesi pa u plotësuar nevojat bazike, të sigurisë dhe mirëqënies fizike, individët nuk mund të lulëzojnë dhe përqëndrohen në shkallë të tjera të piramidës së nevojave si zhvillimi dhe vetaktualizimi.

Për të rinjtë e sotëm, të të dyja gjinive, vetëbesimi renditet si vlera e parë në listë për nga rëndësia, nën ndikimin e narativës së botës moderne ku sukcesi gjithashtu, vlerësohet si mjaft i rëndësishëm.

Vlerat që gjejnë më shumë mbështetje nga vajzat janë të paturit rezultate të mira në shkollë, të qenit të bukur dhe të qenit të fortë. Të paturit një rreth të gjerë shoqëror nga ana tjetër vlerësohet veçanërisht më fort nga djemtë.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm shtetor ose privat është synimi kryesor i adoleshentëve të moshës 14-15 vjeçare në qytetin e Elbasanit. Arsimi i mesëm profesional preferohet vetëm nga një pjesë e vogël e të rinjve, pasi shihet si një zgjedhje që sjell kufizime për të ardhmen universitare. Për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve, largimi nga vendi pas mbarimit të arsimit të mesëm konsiderohet si synim për një shkollim me cilësor, punësim më të sigurt dhe paga më të mira. Lajtmotivi mbizotërues është ai se vendi ynë nuk siguron mundësi të barabarta për njerëzit dhe detyron në një farë mënyre ata që nuk kam lidhje dhe miq të rëndësishëm, t'i drejtohen jetesës me forma jo të mira (vjedhje, krime etj). Si rrjedhim, drejtësia dhe meritokracia renditet e para në listën e aspekteve frymëzuese për një të ardhme më të mirë qoftë kjo në shkollë, në punë apo në shoqëri.

Pavarësisht moshës së tyre kaq të re, siguria dhe mirëqenia ekonomike është epiqendra e mendimeve dhe frymëzimeve të tyre për të ardhmen, duke lënë në fokus dytësor çështje si mjedisi, emancipimi shoqëror, argëtimi, dashuria dhe zhvillimet teknologjike. Problemet në vend që shkaktojnë frikë dhe pasiguri mes të rinjve nuk mungojnë, por sërish pjesa më e madhe e adoleshentëve shprehen optimistë për të ardhmen.

Përtej rezultateve në shkollë, që janë shqetësimi kryesor i jetës së të adoleshentëve të pyetur, duhen lexuar me shqetësim çështjet e tjera në fokus. Kjo grupmoshë deklaron se ka shpesh probleme me bullizimin në shkollë, duhanpirjen dhe përjetim të ankthit e stresit. Një pjesë e konsiderueshme deklarojnë se mes tyre konsumohet alkool dhe hashash, por më rrallë drogëra të forta. Sjelljet shqetësuese të lartpërmendura duket t'i kenë fillimet e tyre në 9 -vjeçare por raportohen padryshim më të shpeshta mes të rinjve në shkollat e mesme.

Ngacmimi ose pasiguria fizike në rrugë, lagjie, shkollë raportohet si ndodhi prej një masë të madhe të të rinjve, veçanërisht vajzave dhe veçanërisht në rrugë. Sipas të rinjve, qyteti i Elbasanit është një qytet i rrezikshëm që kërkon të jesh mjaft i kujdesshëm për të ruajtur sigurinë personale. Të rinjtë e kësaj grupmoshe tentojnë të përfshihen më shpesh në konflikte verbale, veçanërisht me bashkëmoshatarët në shkollë apo lagjie sesa konflikte fizike. Familja dhe shoqëria janë dy pikat e para të kontaktit për ndihmë.

Ndër mikro-mjediset që rrethojnë dhe ndikojnë zhvillimin e adoleshentëve të moshës 14-15 vjeçare, familja është parësore, shoqëria/bashkëmoshatarët dhe mësuesit/shkolla janë në plan të dytë dhe më tej personazhet e famshme nga bota e artit, sportit apo rrjetet sociale.

Familja është pa diskutim pika kryesore e referencës për adoleshentët. Ata kalojnë të shumtën e kohës së lirë duke kryer aktivitete me prindërit, motrat e vëllezërit, ju besojnë fort dhe ndjehen të mbështetur nga familja bërthamë. Prindërit janë modelet kryesore që ata adhurojnë e që konsiderojnë si shembuj pozitivë të cilëve duan t'ju ngjajnë.

Rrjeti shoqëror është pika e dytë e referencës për adoleshentët. Të qenit pjesë e një grupi të gjerë shoqëror ka rëndësi për këtë grupmoshë, të cilët shpenzojnë goxha kohë me njëri-tjetrin dhe ndikohen nga njëri-tjetri në zgjedhjet që bëjnë. Ndonëse niveli i ndikimit prej shokëve e shoqeve është i lartë, adoleshentët shfaqin nivele të moderuara besimi tek shokët e shoqet dhe konsiderata e tyre si figura model është e kufizuar.

Mikro-mjedisi i tretë me rëndësi dhe ndikim tek adoleshentët është pikërisht shkolla dhe mësuesit. Të rinjtë shfaqin nivele të ngjashme ndikimi nga mësuesit sikurse bashkëmoshatarët e tyre, por në aspekte të ndryshme. Mësuesit gëzojnë besueshmëri profesionale në sytë e nxënësve dhe ndikojnë kryesisht në formimin shkollor dhe preferencat e tyre për lëndët e profesionet, kurse bashkëmoshatarët ndikojnë më tepër në pëlqimet, sjelljet dhe aktivitetet që ata zgjedhin. Ndonëse

figura e mësuesit vlerësohet më së shumti pozitivisht nga adoleshentët, janë të pakët ata që i cilësojnë si figura model.

Personazhet e famshëm me talentet dhe stilin e tyre të jetesës janë një tërheqje për këtë grupmoshë, e ndaj ndiqen gjerësisht prej tyre në rrjetet sociale. Megjithatë ata kanë ndikim të moderuar tek të rinjtë dhe zgjedhjet e tyre në jetë. Qartazi, kinematografia, arti, media e rrjetet sociale kanë ndikim më të ulët tek kjo grupmoshë krahasuar me familjen, shoqërinë e madje edhe me shkollën e mësuesit. Figura e shkrimtarit dhe sportistit vlerësohen më shumë pozitivisht sesa aktorët dhe këngëtarët, ndonëse këta të fundit janë kategoria më e ndjekur në rrjetet sociale e më të përmendur si figura model nga e gjithë gama e personazheve të mirënjohur.

Figura model ose shembull është një koncept shumëdimensional për një të tretën e adoleshentëve. Të ndihmohet të tjerët e të bësh vepra të mira është dimension i parë edhe më i rëndësishëm që e veçon një individ dhe e transformon atë në një figurë model tek adoleshentët. Të qenit i/e respektuar nga të tjerët për kontributin, mendimet e veprat/sjelljen është dimension i dytë, paralelisht me të paturit një personalitet të denjë për t'u imituar. Dy dimensionet me më pak peshë në përcaktimin e figurës model janë kujdesi i drejtëpërdrejtë ndaj adoleshentit dhe suksesi i arritur.

Duke zbërthyer konceptin e figurës model në karakteristika të përveçme, kuptojmë se figurat model për të rinjtë janë ata që frymëzojnë të tjerët për vepra të mira, ata që punojnë fort e janë të ndershëm, por jo detyrimisht që kanë shumë para, dhe ata që janë të suksesshëm, por jo detyrimisht të famshëm. Madje pamja, fama dhe paraja janë cilësi të asociuara më pak me figurën model nga adoleshentët e qytetit të Elbasanit.

Ata identifikojnë mesatarisht dy figura model, së pari nga mikro-mjediset e jetës së tyre reale - familja, dhe së dyti nga figurat publike nga fusha të ndryshme. Kjo grupmoshë veçon ndjeshëm anëtarët e familjes si figura model, më shumë sesa nga çdo mikro-mjedis tjetër. Prindërit janë dy figurat kryesore ku adoleshentët gjejnë frymëzim për të qenë njerëz të mirë, shohin shembullin e njerëzve të ndershëm e që punojnë fort, dhe që sakrifikon e kujdeset për ta duke i mbështetur drejt zhvillimit dhe realizimit të ëndrrave. Bota e artit, sportit, medias dhe rrjeteve sociale ofrojnë për adoleshentët mikro-mjedisin e dytë ku ata identifikojnë figurat model që zotërojnë cilësitë shembull. Personazhet publike që më shumë konsiderohen model janë këngëtarët, sportistët dhe aktorët. Emrat e përveçëm janë të shumtë, ndonëse secili me peshë të kufizuar, megjithatë disa nga figurat model më të përmendura janë këngëtarët/reperët shqiptarë, Noizy (8%) Stresi (5%) e Tayna (4%) dhe dy futbollistët me famë botërore, Cristiano Ronaldo (5%) e Lionel Messi (4%).

KAPITULLI I – RISHIKIM LITERATURE E STUDIMESH TË TJERA

1.1 Parathënie për studimin

Shoqata INAC, në kuadër të projektit “Toward a Positive Future”, mbështetur nga “The Resilience Fund” dhe “The Global Initiative Against Transnational Organized Crime”, zhvilloi një studim me fokus të rinjtë e shkollave 9-vjeçare në qytetin e Elbasanit.

Duke qenë se kjo analizë është e para e këtij lloji në rajon, gjetjet dhe rekomandimet e saj do të përcillen edhe tek politikëbërësit, për të kuptuar problemet me të cilat përballlet kjo grupmoshë dhe për të adresuar më mirë nevojat e tyre.

Gjetjet dhe rekomandimet do t’u vlejnjë përfaqësues të shkollave, bashkisë, këshillit bashkiak, prindërve, mediave dhe OSHC-ve të tjera që punojnë në rajon.

Në vijim të kësaj analize, INAC synon të identifikojë modele pozitive që mund të ndajnë përvojën e tyre me nxënës të kësaj grupmoshe, për t’i ndihmuar ata në rrugëtimin drejt së ardhmes. Një fushatë ndërgjegjësuese do të jetë pjesë e projektit, duke synuar të ndihmojnë të rinjtë të kenë modele reale pozitive në komunitetin e tyre, gjë që i bën ëndrrat e tyre të realizueshme, ndërkohë që do të rrisin mundësitë e tyre për zgjedhje të mira dhe mundësi pune në të ardhmen që i mbajnë larg ndikimeve negative.

1.2 Të dhëna mbi qytetin e Elbasanit dhe të rinjtë

Demografike

Bashkia e re e Elbasanit është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t’u administruar. Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60 për qind të popullsisë së bashkisë, ndërsa pjesa tjetër është e ndarë në shumë njësi administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore¹.

Popullata rezidente e bashkisë Elbasan, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 80%. Struktura moshore e popullatës dhe moshë mesatare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 20% grupmoshës (0-14) vjeç.

Ashtu si çdo rajon në Shqipëri, popullsia ka ardhur në rënie gjatë 20 viteve të fundit, në këtë rast me një rënie prej rreth 26%, kryesisht për shkak të migrimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe dinamikave të tjera demografike. Elbasani konsiderohet si një nga zonat me potencial më të lartë migrimi në vend, i dyti pas Vlorës².

Elbasani ka një aktivitet të konsiderueshëm ekonomik, i cili përfaqëson 7% të PBB-së së vendit, duke u renditur i katërti në krahasim me rajonet e tjera³. Megjithatë, duke marrë parasysh PBB-në për frymë, rajoni renditet i dyti nga fundi, duke u konsideruar si një nga rajonet më pak të pasura.

Migrimi

Në studimin "Analiza e tregut rajonal të punës, zhvillimi ekonomik në Elbasan, 2021", thuhet se

¹ <https://aam.org.al/bashkia-elbasan/>

² <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15271.pdf>

³ INSTAT

përveç trendeve natyrore demografike, migrimi i fuqisë punëtore aktive është identifikuar si një problem i madh dhe i qartë, gjë e cila krijon probleme të shumta për çdo politikë të tregut të punës. Dallimet midis mundësive të punësimit në Tiranë dhe Elbasan të shkaktuara nga prirja e përqendrimit, veçanërisht kryeqytet-qytet, dhe strategjive të zhvillimit duhet të reduktohen, pasi fluksi i kapitalit njerëzor ka çuar në mungesë të fuqisë punëtore, por edhe në mungesë sipërmarrjeje. Tendencat e mëtejshme të migrimit (të brendshme ose të jashtme) dominohen kryesisht nga grupmoshat më të reja dhe fuqia punëtore e kualifikuar, duke sugjeruar një efekt shumë më të fortë në reduktimin e ofertës së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe në moshë më të re. Migrimi i fuqisë punëtore të kualifikuar është konfirmuar edhe nga Bashkia Elbasan dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe Formimit Profesional, të cilët pretendojnë se arsyeja kryesore për këtë është ndryshimi i nivelit të pagave. Një shembull tipik është migrimi i punëtorëve teknikë në Gjermani, të cilët përmes trajnimeve të ndryshme fitojnë aftësi të certifikuar dhe migrojnë për të punuar në Gjermani.

Kështu nga 5970 të papunë të regjistruar në vitin 2018 numri i të papunëve të regjistruar në Zyrën Rajonale të Punësimit dhe mundësive është 7249 deri në gusht të vitit 2020⁴ duke u rritur me 1279 persona të regjistruar si të papunë për të marrë pagesën e papunësisë apo ndihmën ekonomike pasi numri i të papunëve konsiderohet më i lartë. Emigracioni i të rinjve dhe mungesa e orientimit në karrierë konsiderohen si faktorët kryesorë të rritjes së papunësisë. Punonjës të kualifikuar shqiptarë përgatiten kryesisht për tregun e punës në Gjermani në profesione ndërtimi, riparimesh, infermierë.

Kriminaliteti

Në tetor 2020, Prokurori i Përgjithshëm i Shqipërisë deklaroi se “në Elbasan po vihen re shenja të qarta të kontrollit të elementëve kriminalë mbi territorin, si dhe mbi jetën ekonomike të qytetit”. Ai tha gjithashtu se “po përballemi me një situatë aspak të zakonshme. Perspektiva e të rinjve të Elbasanit nuk mund të jetë ajo e rekrutimit nga bandat, që duan të kontrollojnë qytetin. Shqipëria, aq më tepër Elbasani, nuk mund të kthehet në një model të Sicilisë së viteve 70-80”.

Policia e Elbasanit⁵ gjatë vitit 2021 ka regjistruar 1312 vepra penale në total, ku të miturit nën moshën 18 vjeç rezultojnë autorë të 44 veprave penale. Sipas policisë, veprat penale në të cilat përfshihen më së shumti minorenët janë: vjedhje, dëmtime të tjera me dashje, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor dhe shkatërrim prone. Policia Elbasan deklaroi se “nisur nga vëzhgimet e kryera nuk ka raste të minorenëve të përdorur nga grupe të organizuara kriminale”.

Studimi i 2016-s "Evoluimi i strukturave të organizuara kriminale në Shqipëri" konstaton se një trend i rrezikshëm që po vërehet në Elbasan është se format organizative të grupeve kriminale në qytet po imitohen nga grupe të rinjsh në zonat rurale përreth. Duke pasur parasysh situatën ekonomike dhe edukimin në rrethina, rrezikohet që të kemi zhvendosje të organizatave kriminale me struktura hierarkike në zonat rurale.

Duke folur për delikuencën e të rinjve dhe angazhimin e tyre me krimin e organizuar, në disa takime të zhvilluara me mësuesit e shkollave të Elbasanit, u përmend se përfshirja e tyre ka nisur që në moshë të re. Duke qenë se krimi i organizuar dhe ekstremizmi nuk janë dukuri që shihen hapur, ato shpesh janë të kamufluara dhe të fshehura në mentalitetin e këtyre zonave. Nga dëshmitë e të rinjve konstatohet se faktori ekonomik është një nga arsyet kryesore që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe krim. Faktorë të tjerë që ndikojnë në to janë lidhjet familjare, mungesa e edukimit dhe mungesa e modeleve reale pozitive. Të rinjtë janë kategoria që mund të rekrutohen lehtësisht dhe mësuesit deklarojnë se në shkollën e mesme, të rinjtë tashmë e kanë krijuar profilin e tyre problematik. Ndaj mendojmë se është e nevojshme që puna me ta të fillojë që në gjimnaz, sidomos me klasën e 9-të, vit ky i rëndësishëm për të rinjtë, ku ata vendosin të lënë shkollën, të fillojnë shkollat profesionale apo të mesme.

⁴ Statistika Zyra Rajonale e Punësimit

⁵ Shkresa e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, dt. 6 maj 2022

Gjatë vitit 2021, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan⁶ janë regjistruar gjithsej 71 procedime penale të reja me 62 të persona/pandehur të mitur. Nga të pandehurit e mitur 59 kanë qenë meshkuj dhe 3 femra, dhe sipas grupmoshës 7 persona kanë qenë deri në 14 vjeç, 16 të grupmoshës 14-16 vjeç, si dhe 39 të grupmoshës 16-18 vjeç. Në lidhje me veprat penale të kryera nga të miturit rezulton se kanë kryer veprën penale të "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" (gjithsej 32 persona të mitur), pasuar nga "Vjedhje" (gjithsej 11 persona) dhe vetëm 2 persona të mitur kanë qenë nën hetim për veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe konkretisht "Prodhimi dhe shitje e narkotikëve". Prokuria pohon se gjatë vitit 2021 nuk ka pasur procedime të veprës "Shtytja e të miturit në krim", ç'ka lë të nënkuptohet që ky fenomen nuk është shumë i përhapur apo problematik, por patjetër që i duhet kushtuar vëmendje dhe kujdes i veçantë.

Shërbime sociale

Në territorin e Bashkisë Elbasan janë ngritur shërbime të kujdesit shoqëror kryesisht në qytet. Pjesën më të madhe të buxhetit të Bashkisë Elbasan e zë "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët" (37.6%). Në qytetin e Elbasanit ekziston vetëm një qendër rinore "Qendra Kulturore e fëmijëve", e cila ofron kurse për pikturë, këngë, kërcim dhe aktrim. Gjithsesi pozicionimi i saj e bën qendrën të paaksesueshme nga të gjithë të rinjtë.

Shkollat 9-vjeçare

Në qytetin e Elbasanit janë 16 shkolla 9-vjeçare. Ato frekuentohen nga 801 nxënës të klasës së nëntë, prej të cilëve 365 janë vajza (45.56%). Ky studim përqendrohet pikërisht në këtë grupmoshë 14-15 vjeçare, tepër e rëndësishme për hapat e mëtejshëm që të rinjtë do të kenë në jetën e tyre.

1.3 Figurat model dhe rëndësia e tyre

Të rriturit ndikojnë në jetën e adoleshentëve në mënyra të ndryshme. Bandura (1971) sugjeron se njerëzit priren të shfaqin sjellje që mësohen me ose pa dashje, nëpërmjet ndikimit të shembullit/modelit. Meqenëse formimi i identitetit është një fokus qendror gjatë adoleshencës, adoleshentët kanë veçanërisht të ngjarë të ndikohen nga të rriturit në mjedisin e tyre (Erikson, 1968). Adoleshentët shpesh shikojnë nga të rriturit për të përcaktuar sjelljet e përshtatshme dhe të pranueshme, si dhe për të identifikuar modelin si ata duan të jenë.⁷

Edhe pse përkufizimet e modeleve kanë ndryshuar, figurat model tradicionalisht janë përkufizuar si të rritur që japin shembullin dhe të cilët vlerësohen nga të rinjtë dhe të cilët ata dëshirojnë t'u ngjajnë. Modelet mund të jenë njerëz të rëndësishëm në jetën e dikujt ose më periferik, dhe mund të përfshijnë prindërit, të afërmit, të rriturit me të cilët nuk kanë lidhje farefisnore dhe moshatarët. Modeli mund të jetë gjithashtu dikush që adoleshenti nuk e njeh personalisht, por ka rënë në kontakt në ndonjë mënyrë tjetër p.sh. përmes medias e rrjeteve sociale. Modelet mund të jenë një forcë e fuqishme për të mësuarit dhe rolet sociale. Ato mund të ndikojnë në mënyrën se si njerëzit e shohin veten dhe botën përreth tyre, në vendimet e tyre dhe drejtimin në jetë. Modelet ndikojnë në qëndrimet dhe sjelljet e fëmijëve dhe adoleshentëve në shumë mënyra e drejtime. Si një shembull i etikës, një model u tregon të tjerëve se si ata duhet të sillen në një rol të caktuar, ndërsa si një simbol i arrijtjeve të veçanta, modeli u tregon të rinjve se ata mund t'i arrijnë qëllimet e tyre.⁸

⁶ Nga shkresa e Prokurorisë, dt. 20 prill 2022

⁷ N. M. Hurd, M. A. Zimmerman dhe Y. Xue. "Ndikimet negative të të rriturve dhe efektet mbrojtëse të modeleve: Një studim me adoleshentët urban". Revista Të Rinjtë & Adolshenca, korrik 2009, 38 (6): 777–789.

⁸ Melissa S. Kearney dhe Phillip B. Levine. "Ndikimi i modeleve, mentorëve dhe medias". E Ardhmja e Fëmijëve Vol. 30 / Nr. 1, pranverë 2020

Prindërit si figurat kryesore model⁹

Kur u kërkohet të identifikojnë persona të rëndësishëm në jetën e tyre, adoleshentët emërtojnë në masë të madhe prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes së tyre të ngushtë dhe më të gjerë (Blyth, Hill, & Theil, 1982; Galbo, 1983; Hendry, Roberts, Glendinning, & Coleman, 1992; Shade, 1983). Ka një trend gjinor, duke patur më shumë gjasa që vajzat të listojnë nënat dhe djemtë baballarët, si të rriturit më domethënës në jetën e tyre (Galbo, 1983).

Studiuesit kanë zbuluar se prindërit kanë ndikimin më të lartë mbi fëmijët e tyre adoleshentë në fushat e shkollës, orientimit në karrierë dhe planifikimit të së ardhmes (Meeus, 1989; Younnis & Smollar, 1985). Më tej, Hendry et al. (1992) sugjeron se ndërsa adoleshentët përpiqen të formojnë identitetin e tyre dhe të zhvillohen në adultë, është kritike për ta që të kenë modele prindërore të së njëjtës gjini me të cilët të identifikohen.

Coleman dhe Hendry (1990) kanë theksuar rëndësinë e funksionit të prindërve si modele, veçanërisht gjatë viteve të adoleshencës. Ata sugjerojnë se të rriturit që mund të shërbejnë si figura modele janë më të nevojshme pikërisht gjatë adoleshencës dhe theksojnë se të rinjtë kanë më shumë gjasa të kërkojnë modele tek prindërit e tyre, tek të cilët ata varen si për njohuri, ashtu edhe për shembuj. Siç vunë re Csikszentmihalyi dhe Larson (1984), adoleshentët shpenzojnë më shumë kohë me prindërit e tyre se çdo të rritur tjetër në jetën e tyre, si pasojë janë më të ekspozuar ndaj vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të prindërve. Në dritën e këtyre gjetjeve, është e dobishme të theksohet se jetesa me prindërit dhe të paturit marrëdhënie pozitive prind-fëmijë rrit probabilitetin që fëmijët të identifikojnë prindin si model.

Pak studiues kanë hulumtuar rëndësinë e të pasurit prindër si modele ose kanë krahasuar përfitimet e të identifikuarit të prindërve si figura model kundrejt të identifikuarit si figura model të rritur të tjerë që nuk janë prindërit. Megjithatë studiuesit kanë identifikuar përfitimet e funksionimit të prindërve si modele për fëmijët e tyre adoleshentë (Bryant & Zimmerman, 2003), zotërimi i modeleve joprindërore të të rriturve mund të jetë një reflektim i rrejtë më të gjerë social të një adoleshenti dhe aftësisë së tij për t'u lidhur me të rriturit. Nga ana tjetër, adoleshentët mund të identifikojnë figura model joprindërore, sepse ata nuk i adhurojnë prindërit e nuk duan t'i përngjajnë. Në çdo rast, të kesh një model joprindëror mund të jetë një tregues i mprehtësisë së një adoleshenti dhe aftësisë për të tejkaluar vështirësitë.

Figurat model dhe përfitimet tek adoleshentët

Disa studiues kanë gjetur një lidhje midis të pasurit një figurë model dhe rezultateve pozitive. Werner (1995) zbuloi se modelet ndihmuan në mbrojtjen e fëmijëve vulnerabël nga disa rreziqe me të cilat përballëshin. Gjetjet treguan se të paturit një të rritur që modelon sjelljet pozitive tek adoleshentët, qoftë kjo figurë model një anëtar i familjes, fqinji, mësuesi i shkollës etj., ishte një faktor i përbashkët tek fëmijët me aftësi përballuese e rikuperuese. Yancey, Siegel, e McDaniel (2002) zbuluan se adoleshentët me një model të identifikueshëm morën nota më të larta, kishin vetëvlerësim më të lartë dhe raportuan identitet më të fortë etnik se bashkëmoshatarët të cilëve ju mungonte prania e një figure model. Për më tepër, këto efekte pozitive ishin edhe më të mëdha nëse adoleshentët do t'i njihnin personalisht këto figura model.¹⁰

McMahon dhe kolegët e tij (2004) zbuluan se të paturit një figurë model lidhej me më pak sjellje agresive dhe më pak ankth dhe simptoma depresive tek adoleshentët. Hurd, Zimmerman dhe Xue (2009) zbuluan se në mesin e adoleshentëve të ekspozuar ndaj ndikimeve negative të të rriturve jo

⁹ N. M. Hurd, M. A. Zimmerman dhe Y. Xue. "Ndikimet negative të të rriturve dhe efektet mbrojtëse të modeleve: Një studim me adoleshentët urban". Revista Të Rinjtë & Adolshenca, korrik 2009, 38 (6): 777–789.

¹⁰ N. M. Hurd, M. A. Zimmerman dhe Y. Xue. "Ndikimet negative të të rriturve dhe efektet mbrojtëse të modeleve: Një studim me adoleshentët urban". Revista Të Rinjtë & Adolshenca, korrik 2009, 38 (6): 777–789.

prindëror, ata që kishin modele të roleve shfaqnin më pak shqetësime psikologjike, dhunë dhe delikuencë jo të dhunshme.¹¹

Studime të tjera kanë lidhur praninë e figurës model me sjelljet dhe gjendjen shëndetësore. Një studim i të rinjve me të ardhura të ulëta tregoi se zotërimi i modeleve mbrota nga disa sjellje të rrezikshme për shëndetin, duke përfshirë përdorimin e alkoolit dhe drogës, përfshirjen në marrëdhënie seksuale dhe pjesëmarrjen në dhunë (Aspy et al., 2004; Oman et al., 2004; Oman, Vesely, Kegler, McLeroy, & Aspy, 2003). Yancey et al. (2011) vuri re se identifikimi i mësuesve dhe anëtarëve të familjes si figura model tek adoleshentët ishte i lidhur në mënyrë domethënëse me sjellje pozitive shëndetësore si p.sh. konsumi i sasisë së duhur të fruta-perimeve dhe aktiviteti i rregullt fizik prej tyre.¹²

Studiuesit shprehen se disponueshmëria e modeleve që përputhen me gjininë e adoleshentit është kritike për ta, sepse është pikërisht gjatë periudhës së adoleshencës që individi zhvillon identitetin dhe përcakton rolin e tij në shoqëri (Zirkel, 2002). Për adoleshentët, qasja në modele që kanë të njëjtën gjini mund të jetë veçanërisht e dobishme. Kjo është e rëndësishme për vajzat e reja, të cilat duke parë modele të gjinisë femërore mund të kenë shembuj të qartë të potencialit dhe arritjeve të vajzave e grave, kanë si rrjedhojë edhe një ide të potencialit të tyre ose shembull për arritjet e mundshme (Zirkel, 2002). Nga ana tjetër, Bryant dhe Zimmerman (2003) shprehen se djemtë adoleshentë me modele mashkullore përfshihen në sjellje më pak problematike sesa djemtë që nuk kishin një model mashkullor.¹³

Modelet negative

Nga ana tjetër, mos të harrojmë se ndikimet e të rriturve mund të jenë pozitive dhe negative, e se disa të rritur mund të jenë më ndikues se të tjerët. Ashtu si modelimi mund të luajë një rol në përvetësimin e sjelljes së përshtatshme, të pranueshme shoqërore, ai gjithashtu mund të çojë në përvetësimin e sjelljes devijuese (Bandura, 1971).

Në një studim të 1998-s, Greenberger, Chen dhe Beam analizuan lidhjet midis perceptimeve të adoleshentëve për sjelljen negative të një të rrituri jo prindëror shumë të rëndësishëm (VIP) dhe sjelljes së adoleshentëve. Ata zbuluan se perceptimet e sjelljes së keqe të VIP-ave ishin parashikuese të sjelljes së keqe të adoleshentëve. Epstein dhe kolegët (1995) zbuluan se nëse personi më i admiruar i një adoleshenti përdor marihuanë, adoleshenti kishte më shumë gjasa të synonte të përdorte marihuanë gjithashtu. Hurd, Zimmerman dhe Reischl (2010) i pyetën adoleshentët për sjelljen e modeleve të tyre dhe zbuluan se sjellja antisociale e shfaqur nga figura model lidhej si drejtpërdrejt ashtu edhe tërthorazi me pjesëmarrjen në dhunë. Në mënyrë të ngjashme, Sharma, Grover dhe Chaturvedi (2010), zbuluan se midis nxënësve të moshës 14-19 vjeç, prania e një modeli familjar që pinte duhan u shoqërua me rritjen e përdorimit të duhanit tek adoleshentët.¹⁴

Studiues të tjerë kanë nxjerrë konkluzionin se të rriturit joprindërorë mund të ndikojnë negativisht te adoleshentët, edhe kur këta të rritur nuk konsiderohen si persona shumë të rëndësishëm në jetën e adoleshentëve. Për shembull, adoleshentët që jetojnë në lagje që karakterizohen nga nivele të larta krimi priren të kenë një sërë modelesh për sjellje kriminale (Shoemaker, 1996). Kështu, intervistat me adoleshentë të burgosur nxorën në pah se vendimet e tyre për t'u përfshirë në sjellje kriminale

¹¹ Noelle M. Hurd, Audrey Wittrup dhe Marc A. Zimmerman. "Modelet gjatë zhvillimit të adoleshentëve". 2011

¹² Ibid

¹³ N. M. Hurd, M. A. Zimmerman dhe Y. Xue. "Ndikimet negative të të rriturve dhe efektet mbrojtëse të modeleve: Një studim me adoleshentët urban". Revista Të Rinjtë & Adolshenca, korrik 2009, 38 (6): 777-789.

¹⁴ Noelle M. Hurd, Audrey Wittrup dhe Marc A. Zimmerman. "Modelet gjatë zhvillimit të adoleshentëve". 2011

ishin ndikuar kryesisht nga modelet negative në mjediset jashtëzakonisht të dhunshme ku ata jetonin (Heide, 1997).¹⁵

Ndikimi i medias tradicionale e bashkëkohore (rrjetet sociale)¹⁶

Sipas ekonomistes Eliana La Ferrara, ka tre mënyra përmes të cilave media mund të ndikojë në sjelljet sociale e ekonomike: (1) ofrimi i informacionit; (2) modelimi i roleve dhe ndryshimi i preferencave; dhe (3) përdorimi i kohës.

Ajo thekson se ofrimi i informacionit mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm në vendet në zhvillim, por ky është një përfitim i dobishëm edhe në vendet e zhvilluara e sidomos për të rinjtë nga grupe të disavantazhuara ose që jetojnë në familje jo të mirinformuara. Një mënyrë e dukshme se si media përdoret për qëllime edukative vjen pikërisht në formën e programeve edukative për fëmijë - tani e disponueshme jo vetëm në televizion, por kudo duke u shpërndarë përmes formave elektronike, internetit, rrjeteve sociale dhe aplikacioneve në celular. Nga ana tjetër, tematika ose ndodhi në filma e seriale mundet gjithashtu të përçojnë mesazhe pozitive ose jo, por edhe të nxjerrin në pah çështje për të cilat të rinjtë duhet të edukohen p.sh. marrëdhëniet intime të mbrojtura dhe shmangia e shtatzanive të padëshiruara apo rrezikut për sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Ekspozimi mediatik nuk u jep vetëm informacion shikuesve, ai mund të ndryshojë qëndrimet dhe preferencat individuale gjithashtu. Media mund ta bëjë këtë duke e lartësuar ose duke e ofenduar një aktivitet/sjellje; mund ta bëjë këtë duke e shoqëruar një aktivitet me një personazh mediatik të admiruar (pozitiv) ose të padëshiruar (negativ). Të shohësh personazhin e admiruar duke studiuar shumë e duke u mirësjellë me bashkëmoshatarët në shkollë mund ta bëjë idenë e të qenit një nxënës i zellshëm një koncept më të mirëpranuar për shikuesit e rinj. Nga ana tjetër, nëse një personazh i njohur televiziv bën diçka që konsiderohet e neveritshme, antisociale ose e paligjshme (si p.sh. abuzimi me narkotikët), kjo gjithashtu mund t'i shtyjë shikuesit e rinj ta mirëpranojnë a ta mbështesin këtë sjellje, e madje edhe ta adoptojnë sjelljen e vëzhguar.

Një efekt i veçantë buron nga koha e përthithur nga media dhe, veçanërisht, nga aktivitetet e stërbushura nga koha e medias. Për shembull, zgjedhja e një adoleshenti për të parë televizor ose video në rrjetet sociale në vend që të luajë jashtë ose të studiojë për shkollën krijon një efekt zëvendësues të kohës. Studiuesit në fushën e komunikimit besojnë se edukimi përmes programeve argëtuese mund të ofrojë një mënyrë më efektive për të ndikuar qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve sesa mesazhet e drejtëpërdrejta tradicionale, sepse mund të zbusë nivelet e rezistencës krahasimisht me ato ndaj mesazheve që synojnë të bindin audiencën në një aspekt ose në lidhje me një tematikë të caktuar.

Të dhënat e viteve të fundit tregojnë se ekspozimi ndaj përmbajtjeve mediatike të caktuara mund të kenë efekte të konsiderueshme pozitive në qëndrimet, sjelljet dhe rezultatet sociale dhe edukative tek të rinjtë. Një sërë studimesh të dukshme tregojnë se televizioni mund të ketë efekte të dobishme - të qëllimshme dhe të paqëllimshme (Matthew Gentzkow e Jesse Shapiro, 2008). Ndërkohë që nuk ka ende ndonjë dëshmi shkakësore në lidhje me ndikimet e ekspozimit ndaj personaliteteve të mediave sociale ose mediave sociale në përgjithësi.

¹⁵ N. M. Hurd, M. A. Zimmerman dhe Y. Xue. "Ndikimet negative të të rriturve dhe efektet mbrojtëse të modeleve: Një studim me adoleshentët urban". Revista Të Rinjtë & Adoleshenca, korrik 2009, 38 (6): 777-789.

¹⁶ Melissa S. Kearney dhe Phillip B. Levine. "Ndikimi i modeleve, mentorëve dhe medias". E Ardhmja e Fëmijëve Vol. 30 / Nr. 1, pranverë 2020

KAPITULLI II – METODOLOGJIA

Organizata INAC është krijuar si një nevojë e komunitetit të Elbasanit për një zë të fortë për problemet e saj. Në punën e kryer në terren, marrë parasysh deklaratat e shumta që e identifikojnë Elbasanin si një qytet i kontrolluar nga krimi i organizuar, por edhe të prekur ndjeshëm nga radikalizmi, INAC vendosi që të kryejë takime me mësues të shkollave të këtij qarku, të cilët deklaruan se qytetarët e Elbasanit të identifikuar si të angazhuar me krimin e organizuar, e kanë nisur përfshirjen e tyre që në moshë të re.

INAC pas konsultimit me mësues të këtij qyteti, vendosi të bëjë analizojë se cilët janë ndikuesit më të mëdhenj në jetën e të rinjve, duke qenë edhe kategoria që rekrutohen më lehtë.

Si rrjedhim, INAC ndërmori këtë projekt studimor me fokus adoleshentët e klasave të 9-ta në qytetin e Elbasanit i cili kishte tri objektiva kryesorë:


- Të kuptojë perspektivën e adoleshentëve, perceptimet, besimet, shqetësimet dhe aspiratat e tyre;
- Të kuptojë mjedisin rrethues dhe aspektet që ndikojnë tek adoleshentët, sjelljet dhe zgjedhjet e tyre;
- Të kuptojë perceptimet e 14-15 vjeçarëve mbi figura model dhe të identifikojë shembuj pozitivë që ata i konsiderojnë figura model për t'u ndjekur.

Ky studim u zbatua sipas një përjasjeje metodologjike të kombinuar me adoleshentë nga të gjitha shkollat 9-vjeçare të qytetit të Elbasanit, të cilët gjatë periudhës së studimit ndiqnin klasën e 9-të.

Faza e parë, ajo cilësore u zhvillua në formën e grupeve të diskutimit. Në total, u zhvilluan 4 fokus grupe me 7-9 pjesëmarrës secili. Dy grupe diskutimi u zhvilluan veçmas me vajzat dhe 2 grupe të tjera me djemtë, për të mundësuar një diskutim sa më hapur e të pandikuar nga prezenca e gjinisë së kundërt. Udhërrëfyesi për fokus-grupet është një instrument gjysëm i strukturuar, pyetjesh e të cilit u përshtatën për grupmoshën dhe në disa raste për gjininë. Për më shumë informacion, gjeni udhërrëfyesin e plotë si Aneks B të këtij raporti.

Faza e dytë, ajo sasimore u zhvillua në formën e një ankete sasimore online, e cila u shpërnda me ndihmën e stafit pedagogjik dhe u vetadministrua nga ana e subjekteve pjesëmarrëse, nxënës të klasave të 9-ta nga 12 dhjetori 2021 deri në 2 mars 2022. Anketa u shpërnda në të gjitha shkollat 9-vjeçare të qytetit të Elbasanit duke synuar që kampioni prej 260 nxënësisht të siguronte gjithëpërfshirjen, sikurse paraqitet në figurën 1. Nga pjesëmarrësit, 53% ishin vajza dhe 47% ishin djem të klasave të 9-ta. Për finalizimin e pyetësorit sasior, u konsideruan disa nga gjetjet e fazës cilësore për t'i përshtatur edhe më mirë pyetjet me audiencën. Për më shumë informacion, gjeni pyetësorin e plotë si Aneks C të këtij raporti.

Figura 1



KAPITULLI III – GJETJET STUDIMORE

Ky kapitull përshkruan analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore të mbledhura në harkun kohor të këtij studimi, sipas këndvështrimit të nxënësve të klasave të 9-ta në qytetin e Elbasanit.


Gjetjet paraqiten në total dhe në të gjitha rastet të dhënat në grafikë tregojnë përqindjen e përgjigjeve të grupuara në secilën kategori bazuar tek kampioni përkatës. Në disa raste, të dhënat paraqiten edhe sipas këndvështrimit gjinor.

3.1 Stili i jetesës dhe nevojat e paplotësuara

Aktivitetet kryesore të të rinjve

Familja është struktura bazë e jetës rinore dhe ndikuesi më i fuqishëm në zgjedhjet dhe jetën e të rinjve 14-15 vjeçare të qytetit të Elbasanit. 8 nga 10 të rinj kalojnë shpesh kohë me familjen, ndërsa 19% shprehen se ndodhë ndonjëherë. Udhëtimet gjatë fundjavës për të kaluar kohë cilësore me njëritjetrin ose vizituar familjen e gjerë, janë gjithashtu një ndodhi familjare që ndodhë shpesh (23%) ose ndonjëherë (67%). Vajzat kalojnë më shumë kohë në familje dhe i kushtojnë ca më shumë vëmendje kujdesit për fëmijë më të vegjël në familje, ose punëve të shtëpisë ndërkohë djemtë deklarojnë më shumë varietet në mënyrën sesi e shpenzojnë kohën e lirë. Shëtitjet dhe koha e kaluar me shokë e shoqe, gjithashtu ka ngjyrim gjinor. Vajzat socializojnë më së shumti më njëritjetrën në lagje, shëtitje ose edhe në kafe, ndërsa djemtë socializojnë në të njëjtat hapësira por për më tepër gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme veçanërisht ato sportive. Gjatë grupeve të diskutimit të rinjtë flasin për termin "stereotipe gjinore të krijuara nga shoqëria" në kuadër të kufizimeve shtesë që vajzat kanë, krahasuar me djemtë, më së shumti për daljet jashtë shtëpisë dhe nevojën për leje nga familjarët për çdo lëvizje dhe zgjedhje.

Figura 2




Virtualiteti është një shtresë e dytë që i mbivendoset realitetit të tyre social, por për fat të mirë aktivizimi në jetën reale me aktivitete të ndryshme është akoma i lartë. Rrjetet sociale janë struktura kryesore virtuale ku të rinjtë shpenzojnë kohë (72% shpesh dhe 24% ndonjëherë), ndjekur nga interneti për lexime, video (60% shpesh dhe 37% ndonjëherë) dhe lojëra elektronike në celular ose pajisje të tjera (41% shpesh dhe 48% ndonjëherë).

Rrjetet ku të rinjtë zotërojnë llogari dhe shpenzojnë më shumë kohë janë: WhatsApp, Instagram, Snapchat, TikTok, YouTube, Discord, ndërkohë që Viber dhe Facebook janë më pak të përdorur pasi gjykojnë si të përshtatshme më së shumti për moshën e tretë. Të rinjtë dhe të rejtat deklarojnë se shpenzojnë mesatarisht 2-3 orë në ditë në rrjetet sociale dhe i përdorin ato për t'u shprehur dhe shfaqur talentet e tyre me anë të fotove/videove që postojnë, për të flirtuar mes tyre, për të luajtur lojëra, për të komunikuar me familjarët dhe miqtë, për t'u informuar, për të mësuar, si edhe për të ndjekur personazhe të famshme.

Rrjetet sociale kanë ndikim madhor në 1 ndër 4 të rinj, më së shumti për stilin e jetesës, veshjes dhe zhvillimin e talenteve të tyre (Figura 30). Gjysma prej tyre deklaroi se rrjetet sociale kanë disi ndikim në zgjedhjet e tyre dhe 1 në 4 të tjerë, se rrjetet sociale nuk kanë aspak ndikim, të paktën sipas përjetimit dhe perceptimit të tyre, pavarësisht se ky ndikim mund të jetë i pavetëdijshëm.

Figura 3



Muzika është lajtmotivi i jetës rinore, shoqëruese e përhershme, relaksuese, ndaj merr edhe përqindjen më të lartë ndër gjithë aktivitetet e tjera (86% e dëgjojnë shpesh dhe 13% ndonjëherë). Mediumet ku aksesohet muzika janë më së shumti personale si p.sh. aparati celulari, ndërkohë që koncertet ose aktivitete të tjera rreth muzikës përmenden pothuajse shkarazi prej të rinjve, në kuadër të disa organizimeve mes shkollave.


Angazhimi i të rinjve në pasione dhe sporte të ndryshme vjen pas familjes dhe teknologjisë në përqindje dhe reflekton padyshim diferenca gjinore. Sportet si futbollli, volejbollli, basketbollli, boksi, artet marciale dhe veglat e forcës në palestra, janë aktivitete të ndjekura qoftë si pjesëmarrës aktiv (39% luaj shpesh sporte) ashtu edhe si ndjekës pasiv në TV, internet, stadium (33% ndjek shpesh). Sportet e ndryshme tërheqin ca më tepër djemtë se vajzat, duke qënë se 1 në 2 prej tyre deklarojnë përfshirjen në vetë të parë. Vajzat deklarojnë si pasion aktivitete fizike si volebollli, futbollli po edhe ato më të moderuara si shëtitjet në këmbë ose me

biçikletë (30%). Vetëm 17% e vajzave ndjekin aktivitete sportive në formë pasive kundrejt 49% e djemve.

Vajzat pohojnë pasione si vizatimi, piktura, aktrimi, muzika, gatimi, kujdesi për kafshët, udhëtimet etj. Padyshim ka një kryqëzim të pasioneve dhe interesave të lartpërmendura mes dy gjinive, por ato duket të kenë frekuencë më të ulët tek djemtë.

Të ardhurat familjare duket se janë të lidhura me mundësinë e të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete, si edhe gjinia. Të dyja gjinitë vlerësojnë se ka diferenca në aktivitetet që kryejnë vajzat dhe djemtë, nisur nga stereotipet gjinore dhe mendësia që ekziston në shoqëri. Megjithatë të rinjtë nxitonjë të përjashtojnë veten dhe familjet e tyre ndaj fenomeneve diskriminuese duke i deleguar tek të tjerët që vërteton dëshirën për mos t'i ndjekur si modele sociale.

Figura 4




Televizioni ka një rol relativisht të dobët në jetën e të rinjve pasi vetëm 38% e tyre deklarojnë se e ndjekin shpesh dhe për më tepër gama e programacionit të ndjekur kufizohet në seriale dhe filma. Për më tepër media konsiderohet nga të rinjtë si një aktor me peshë të ulët ndikuese në zgjedhjet e tyre, krahasuar me të tjera, si familja, shkolla apo shoqëria. Konkretisht 18% e të rinjve besojnë se media ndikon shumë në zgjedhjet dhe jetën e tyre, ndërkohë që gjysma mendojnë se ka disa ndikim, por jo të qënësishëm.

Letërsia, nuk përqafohet rregullisht nga të gjithë, por për ¼ e të rinjve është aktivitet i integruar mirë në jetën e përditshme. Dallimi gjinor është tejet i konsiderueshëm duke qenë se vajzat lexojnë 3 herë më shumë se djemtë (33% e vajzave lexojnë shpesh kundrejt 11% e djemve).

Feja prek një segment akoma më të ngushtë pasi vetëm 12% ndjekin aktivitete fetare shpesh dhe 20% e të rinjve deklarojnë se feja ka shumë ndikimin në zgjedhjet e tyre në jetë. Ndryshe nga letërsia, feja tërheq dhe afron disi më tepër rreth saj, djemtë. 16% e djemve deklarojnë se ndjekin shpesh aktivitete fetare (shkojnë në kishë/xhami) kundrejt 8% e vajzave ose polariteti tjetër; 44% e djemve nuk i ndjekin asnjëherë kundrejt 66% e vajzave që deklarojnë se nuk i ndjekin asnjëherë. Për më tepër, 32% e djemve dhe 18% e vajzave shprehen se kanë besim të plotë tek udhëheqësit

fetar. Pavarësisht lidhjes jo fort masive me fenë, Zoti përmendet në grupe diskutimi në rolin e një influence frymëzuese dhe mbështetëse në jetët e tyre.

Figura 5




Prioritetet për të përmirësuar jetën e të rinjve në qytetin e Elbasanit

Nxënësit deklarojnë se ka mungesa në aktivitetet kulturore, sociale, si dhe të hapësirave për të praktikuar sport, dhe shumica e koncerteve dhe konkurseve janë ato që zhvillohen brenda shkollave. Shoqëria dhe interneti rezultojnë të jenë burimet kryesore të informacionit për të rinjtë lidhur me aktivitetet jashtëshkollore. Pavarësisht mungesave të mësipërme, të vënë para listës së prezantuar si prioritete potenciale, theksi vihet tjetërkund, pra tek siguria dhe strukturat shkollore.

Të rinjtë e klasave të 9-ta në qytetin e Elbasanit mendojnë se prioritet për të përmirësuar jetën e të rinjve në qytetin e Elbasanit janë siguria në shkollë dhe rrugë, si edhe kushtet më të mira në shkollë, duke dëshmuar situatën e rënduar social – kriminale në qytet. Vajzat e vënë theksin tek siguria disi më fort (49%), por gjithsesi edhe për djemtë siguria në rrugë dhe shkollë merr vendin e parë dhe vlerësohet si prioritet absolut për 43% prej tyre.

Kushte më të mira në shkollë është prioritet tjetër madhor sipas vetë të rinjve, sikurse edhe bazik, duke qenë se është baza, struktura e domosdoshme për të mbështetur mësimdhënien, potencialin e të rinjve për të përfutur dije dhe për të dhënë rezultate. Shkolla të ftohta, klasa të vjetra etj. krijojnë një strukturë psiko-emocioanale të pashëndetshme për të rinjtë dhe nuk ndihmojnë shpalosjen e potencialit të tyre. Aktivitet e rëndësishme për zhvillimin e të rinjve dalin pra në plan të dytë si nevoja dhe renditen më ulët në listën e prioriteve duke qenë se siguria dhe kushte në shkolla janë baza mbi të cilën mund të zhvillohen këto te dyja. Në rend të dytë janë nevojat e natyrshme të të rinjve si p.sh. hapësira për të zhvilluar pasionet e tyre (spot, art, teknologji), aktivitete për të mbështetur socializimin dhe konkurrueshmërinë (konkurse, qendra rinore dhe kulturore) dhe hapësira natyrale rekreativiteti si parqe dhe hapësira të gjelbra për të qenë në kontakt me natyrën.

Figura 6



Të rinjtë mendojnë se duhet të investohet në infrastrukturë dhe në shtimin e hapësirave publike, në mënyrë që të rinjtë të kenë mundësi më të mëdha për aktivitete më së shumti fizike.

Figura 7

Nevojat e të rinjve për ambiente dhe aktivitete.... me fjalët tona

"Terrenet ku luajmë futboll janë private ndaj paguajmë ose bejme porta me gura në lagje. Duhet të shtohen hapësirat sportive në çdo lagje, të ketë kaçeto pa pagesë dhe fusha sportive të ndryshme.

"Mungojnë parqet e lojërave për fëmijët e vegjël dhe hapësirat e gjelbërta janë të pakëta edhe për ne.

"Tek teatri Skampa duhet të kishte më shumë shfaqje duke qenë se edhe ne jemi në një situatë pandemie dhe do duhet ta çlirojmë stresin duke parë teatro ose duke parë filma. Do të duhej edhe një kinema në Elbasan dhe besoj se të gjithë moshatarët tanë do të donin një të tillë".

"Ka mjaft kufizime në Elbasan, ndryshe është Tirana që ka plot vende dhe aktivitete".

Vlerat e përqafuara nga të rinjtë

Vërtet nuk e kemi një studim të vlerave të brezave ose të të rinjve në dekada të tjera në Shqipëri por autorët e këtij raporti paraparagjykojnë se, të paturit vetëbesim nuk ka qenë e para në listë. Për të rinjtë e sotëm, të të dyja gjinive, vetëbesimi renditet si vlera e parë në listë për nga rëndësia, nën ndikimin e narrativës moderne, tregut të lirë ku element i rëndësishëm i suksesit është vetëbesimi dhe nën ndikimin e kulturës së rrjeteve sociale. Suksesi gjithashtu, nën të njëjtën filozofi, vlerësohet si mjaft i rëndësishëm nga 88% e të rinjve dhe disi nga 1 në 10 e tyre. Të qëniti i sjellshëm nuk ka dalë akoma nga moda për fat të mirë dhe përqafohet si vlerë e rëndësishme nga një pjesë e madhe e të rinjve, së bashku me të qëniti i ditur dhe i mirëinformuar, e përqafuar kjo e fundit, disi me fort nga vajzat se djemtë.


Pozitiviteti dhe mbështetja dhënë të tjerëve mbetet një shtyllë e rëndësishme, vlerë universal, që vlerësohet dhe përqafohet si tepër e rëndësishme nga 8 në 10 të rinj, në masë të ngjashme për të dyja gjinitë.

Vlerat që gjejnë më shumë mbështetje nga vajzat se djemtë janë të paturit rezultate të mira në shkollë (11% diferencë) të qëniti të bukur (6% diferencë) dhe të qëniti të fortë (14% diferencë). Kjo e fundit pavarësisht pritshmërive, ose pikërisht prej tyre, duket të jetë e rëndësishme për vajzat që duket se ndiejnë nevojën e të kapërcyerit të stereotipeve gjinore mbi brishtësinë e tyre.

Të paturit një rreth të gjerë shoqëror nga ana tjetër vlerësohet veçanërisht më fort nga djemtë respektivisht me diferencë 17% nga vajzat.

Duhet theksuar se masa e të rinjve që i shohin të parëndësishme këto vlera, është shumë e vogël ndaj të gjitha mbeten të rëndësishme pavarësisht renditjes dhe forcës së ngjyrimeve.

Figura 8



3.2 Çështje problematike në jetën e të rinjve

Shqetësimet e të rinjve në qytetin e Elbasanit

Epiqendra e jetës e grupmoshës në studim dhe pritshmëritë ndaj tyre janë të fokusuara tek shkollimi, ndaj si rrjedhim shqetësimi kryesor i tyre lidhet me rezultatet akademike dhe vështirësitë e tyre. Në masën e duhur, ky shqetësim mund të shërbej si katalizator për të përmirësuar rezultatet ose për të vënë përpjekjet aty ku duhet, ndaj jo detyrimisht ky rezultat duhet të lexohet me ngjyrim negativ.

Nga ana tjetër, në mënyrë shqetësuese duhet të lexohen rezultatet e tjera, ku 1 në 3 të rinj pohojnë se kjo grupmoshë ka shpesh probleme me bullizimin në shkollë, duhanpirjen dhe përjetim të ankthit e stresit, problematika këto që shtrihen deri në 62%-73% edhe pse me frekuencë më të ulët. Bullizmi, paragjykimet dhe dhuna verbale raportohet të ndodhin më së shumti mes djemve, ndërsa pranojnë në diskutime se ka edhe femra dhunuese.

Gati gjysma e tyre deklarojnë se konsumohet alkool dhe hashash, por kjo sjellje ndodh shpesh sipas 16%-17% të të rinjve. Ndonëse më të rralla, duhen parë me shqetësim, problemet me përdorimin e drogave të rënda dhe përfshirja në grupe kriminale që deklarohen si shqetësime nga të pakten 1 në 3 të rinj. Duhet theksuar që deklaratimet janë perceptime rreth realitetit të të rinjve në qytetin e Elbasanit, pra jo detyrimisht përjetime personale të të intervistuarve. Matja vlerëson perceptimin rreth shqetësimeve të tyre ose bashkëmoshatarëve rreth tyre për të na dhënë një tablo të përgjithshme të të rinjve në qytetin e Elbasanit. Gjatë diskutimeve me të rinjtë, vihet theksi tek diferencat mes të rinjve në përfundim të arsimit 9-vjeçar dhe atyre në arsimin e mesëm. Sjelljet shqetësuese të lartpërmendura duket t'i kenë fillimet e tyre në 9-vjeçare, por që janë më të shpeshta mes të rinjve në shkollën e mesme.

Arsyetimet e sjella mbi angazhimin e të rinjve në sjellje jo të mira janë edukata e pamjaftueshme familjare ose problemet në familje, bullizmi, stimuli i parave dhe famës, joshja që i bëhet nga shoqëria e keqe, depresioni, dëshira rinore për adrenalinë, dëshira për të provuar gjëra të reja etj.

Ngacmim ose pasiguri fizike në rrugë, lagjie, shkollë raportohet si ndodhi prej 62% e të rinjve dhe prej 1 në 4 të rinj perceptohet si ndodhi e shpeshtë. Diferencat më të dukshme përsa i përket ngacmimeve ose pasigurive fizike në rrugë, gjenden në masën e atyre që deklarojnë se nuk ndodhin pasi 40% e djemve deklarojnë se nuk ndodhin asnjëherë kundrejt 25% e vajzave.

Grupet e diskutimi vetëm me vajza nxori në pah se shpesh bashkëmoshataret e tyre janë të rrezikuara nga ngacmimet në rrugë më shumë se nga ngacmimet në shkollë. Ato pohojnë se një pjesë e mirë e vajzave ngacmohen nga djem dhe burra të rritur, ca më tepër se nga bashkëmoshataret e tyre. Ndërkohë nga ana tjetër grupet e diskutimit me djem konfirmojnë si problematike përndjekjen e vajzave nga bashkëmoshatarët e tyre, qofshin këto vajza moshatare apo edhe më të vogla. Për fat të keq vetë vajzat fajësojnë vetë bashkëmoshataret e tyre për ngacmimet në rrugë, por gjithashtu edhe për rastet e trafikimit. Të ndikuara nga opinionet e më të rriturve, ato e vënë theksin tek faji i vajzave provokuese në veshje dhe sjellje duke lënë mënjanë në gjykim fajtorët e vërtet të këtyre ndodhjeve. Vajzat pohojnë se mbështetja nga policia është e pandjeshme për shkak të mendësisë që ekziston, frikës se tyre për t'u shprehur dhe turpit nga gjykimi.

Figura 9



Konsiderata për sjellje të gabuara në shoqëri

Çfarë konsiderohet vlerë në shoqëri zakonisht lë vend për më shumë diskutim, sesa çfarë konsiderohet antivlerë. Sjelljet e gabuara dhe të papranuara nga shoqëria, madje edhe nga ligji, kanë një farë uniformiteti siç tregojnë edhe rezultatet e këtij studimi. Në mënyrë pothuaj unanime trafikimi i njerëzve dhe vjedhja konsideron si sjellje të gabuara, pasuar nga diskriminimi gjinor, bullizmi dhe kultivimi, përdorimi dhe shitja e drogës. Pavarësisht se dikush mund t'i lexoj këto rezultate si të pritshme, konfirmimi i tyre është i rëndësishëm për të kuptuar masën e ndikimit të sjelljeve devijante në shoqërinë përreth, në perceptimet e tyre për të mirën, të keqen dhe zonën gri në mes. Nëse do të përqendrohemi te çfarë konsiderohet “as e drejtë dhe as e gabuar” mund të zbulojmë disa nuanca interesante në gjetjet studimore. Duket se 17%-22% e të rinjve, disa sjellje si konsumi i alkoolit dhe duhanit, lënia e mësimit, përdorimi i fjalorit banal, gënjeshtria kundrejt mësuesve apo ndërtimi i shtëpive pa leje, janë të pranueshme.


E vetmja sjellje me nuanca pozitive është pjesëmarrja në protesta, pasi 1 në 4 të rinj e shohin si sjellje të gabuar, ndërsa gjysma si sjellje neutral, pa ngjyrim. Gjithsesi 1 në 4 të rinj e perceptojnë protestën si sjellje negative, të ndikuar potencialisht nga retorika negative që përdoret rëndom ndaj protestuesve të ndryshëm në Shqipëri, nga pushteti ose edhe nga vetë shoqëria ndaj protestave të kaheve të ndryshme politike nga ajo që mbështesin.

Disa dallime gjinore, statistikiisht domethënëse mes djemve e vajzave i gjejmë tek toleranca dhe mirëpranimi si sjellje të drejta të lënies së orëve të mësimit (vajzat 3% kundrejt djemve 9%), mbajtja e armëve të ftohta (vajzat 2% kundrejt djemve 9%) dhe armëve të zjarrit (vajzat 1% kundrejt djemve 7%), si edhe konsumi i alkoolit (vajzat 1% kundrejt djemve 7%).

Sjelljet dhe mendimet që shoqëria nuk i pranon, janë të vështira për t'u identifikuar në studime me vetëdeklarim pasi tendenca njerëzore është e tillë, që fsheh qëndrimet që mund t'i ekspozojë ndaj gjykimeve të jashtme. Nga ana tjetër nuk ka vend për të dyshuar deklaratimet e

shprehura, pasi mosha e vogël e respondentëve nënkupton se ata janë akoma në një fazë formimi dhe si rrjedhim mendimet e tyre janë në linjë me qëndrimet gjenerale të shoqërisë dhe familjarëve, pasi nuk kanë arritur atë fazë individualizmi që mund t'i kundërvihen ose gjetur argumenta për t'ju kundërvënë.

Figura 10



Faktorët motivues të paragjyqimeve dhe diskriminimeve mes të rinjve

Faktorët që stimulojnë më shumë bullizëm mes të rinjve janë orgjina veçanërisht ajo nga fshati (29%), por me pak ajo etnike si p.sh. komuniteti rom, egjiptian etj (22%).


Statusi ekonomik ose pozita e prindërve gjithashtu është faktor për të paragjykuar bashkëmosharët që pohohet nga rreth 22% dhe 24% e të rinjve si i shpeshtë, por përqindjet e deklaruar se ndodh ndonjëherë janë gjithashtu të rëndësishme dhe mund të shpjegojnë ndjesinë e pabarazisë të shprehur më herët.

Diskriminimi prej aftësive të kufizuara ndodh diçka më rrallë (17% shpesh dhe 28% ndonjëherë) duke qenë se segmenti është relativisht i vogël, por edhe ai prej përkatësisë fetare (12%

shpesh dhe 28% ndonjëherë) duke qenë se të rinjtë nuk kanë masivisht interes për fenë (figura 4).

Diskriminimi për shkak të gjinisë deklarohet si i shpeshtë nga 14% e të rinjve dhe më i rrallë mes 41% prej tyre, gjithsesi diskutimet tregojnë se shumë sjellje me dallim gjinor, merren për të mirëqëna në mungesë të shembujve të ndryshëm alternativ dhe të shëndetshëm për t'ju referuar. Interesant është dallimi statistikisht domethënës mes përgjigjeve të djemve që deklarojnë në masën 48%, se diskriminim gjinor nuk ndodh asnjëherë kundrejt 34% të vajzave që deklarojnë se nuk ndodh asnjëherë.

Figura 11



Përfshirja në konflikte e të rinjve

Sipas të rinjve, qyteti i Elbasanit është një qytet i rrezikshëm, mendim i krijuar nga situata në qytet por edhe konfirmuar për ta nga "media". Ata mendojnë se ky është mendimi i "të gjithëve", pra është një diskutim i artikuluar më herët rreth tyre dhe mes tyre.

Të rinjtë e kësaj grupmoshe tentojnë të përshihen më shpesh në konflikte verbale, veçanërisht me bashkëmoshatarët në shkollë apo lagjie sesa konflikte fizike. Gjatë vitit të fundit 1 në 2 adoleshentë (50%) pohojnë se janë përfshirë në konflikte verbale me bashkëmoshatarët, familjarët ose stafin pedagogjik, ndërkohë 3 nga 10 janë përfshirë në konflikte fizike.

Pjesëmarrësit në fokus-grupe thonë se të rinjtë që përfshihen në konflikte tentojnë hera-herës të përfshijnë edhe të tjerë në këto veprime dhe te zgjerojnë rrethin e konfliktit, gjithsesi janë të ndërgjegjshëm se askush nuk mund t'i detyrojë të përfshihen pa dëshirën e tyre dhe pranojnë rolin e tyre. Familja dhe shoqëria janë dy pikat e para të kontaktit për ndihmë. Në rastet ekstreme, kur situata është e pashmagshme me mënyra të tjera, pohojnë se do t'i drejtoheshin policisë. Mësuesve apo psikologëve në shkolla do t'u drejtoheshin vetëm në rastet kur çështja ka lidhje me shkollën ose nëse ndodh brenda shkollës. "Nuk mund të mbrohesh çdo herë, por me pak nuhatje për të vlerësuar rrezikshmërinë e situatave dhe tërheqjen në momentin e duhur, mund t'ja hedhësh" shprehen disa djem te rinj në grupe diskutimi.

Dallimet gjinore nuk janë të thella tek konfliktet verbale por ndërkohë janë më të dukshme tek konfliktet fizike pasi 79% e vajzave deklarojnë se nuk janë përfshirë në konflikt fizik kundrejt 61% e djemve. Për më tepër përsa i përket konflikteve fizike në shkollë, përfshirja e djemve deklarohet në masën 11% ndërsa e vajzave në masën 3%.

Figura 12




3.2 Aspiratat dhe synimet drejt së ardhmes

Planet për të ardhmen

Të pyetur se ku e shohin veten pas një viti, 79% e të rinjve deklarojnë se do të vazhdojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm publik ose privat ndikuar nga kushtet ekonomike familjare. Arsimi i mesëm profesional, është synim për 12% e të rinjve, ndërkohë për të tjerët shihet si një zgjedhje që sjell kufizime për të vijuar studimet universitare brenda ose jashtë vendit. Arsye të tjera minore në mbështetje të arsimit të mesëm të përgjithshëm kundrejt atij profesional janë cilësia e shkollës, si dhe njohja e vetes dhe aftësive personale në dimensione të ndryshme para vendimit për një profilizim të caktuar. Orientimi familjar drejt arsimit të mesëm të përgjithshëm është më e theksuar tek vajzat sesa tek djemtë dhe vendimarrja personale është gjithashtu më e kufizuar tek kjo gjini. Lidhur me zgjedhjen e degës për studime universitare, të rinjtë përcaktojnë si faktor vendimarrës, talentin ose zotësinë e tyre në degën apo drejtimin e caktuar, si edhe potencialin e degës për t'ju siguruar të ardhura të qëndrueshme në tregun e punës.


Figura 13



Për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve, largimi nga vendi konsiderohet si synim për të ardhmen. Jetesa dhe shkollimi në Shqipëri konsiderohet problematike dhe nuk ka cilësinë e vendeve perëndimore. Shkolla më të mira dhe paga më të larta janë arsyet kryesore pse të rinjtë duan të ndërtojnë të ardhmen në këto vende. Gjatë diskutimeve, fokusi duket të jetë gjithmonë tek përgjegjësia e shtetit dhe nuk ndahet mes aktorëve të tjerë të arenës publike ose duke marrë përgjegjësi personale apo familjare, për t'u fuqizuar dhe ndryshuar situatën e papëlqyer në vend, për të përmirësuar shkollimin, tregun e punës apo rritur cilësinë e jetesës. Pas 4-5 viteve shumica e të rinjve e shohin veten në vende si Italia, Gjermania dhe Anglia, që janë zgjedhjet kryesore për të vijuar arsimin e lartë ose punuar. Një pjesë e të rinjve që synojnë të jetojnë në Shqipëri, planifikojnë të vazhdojnë zhvillimin e bizneseve familjare ose do të fillojnë të punojnë, qoftë edhe paralelisht me studimet universitare për të siguruar të ardhura dhe pavarësi. Ndryshe nga djemtë, vajzat rezultojnë disi më të qarta përsa i përket profesioneve që duan të ndjekin, pavarësisht se në klasën e nëntë. Degët më të preferuara për to janë mjekësia, infermiera, fizioterapia etj, degë që kanë kërkesë në tregun ndërkombëtar dhe ju japim mundësi për t'i ushtruar kudo.

As vajzat dhe as djemtë nuk e shohin veten në pozicionin e kryefamiljarit në 4-5 vitet në vijim dhe moshë 20 vjeçare konsiderohet gjerësisht, si tepër e re për të krijuar familje.

Figura 14




Përjetime rreth të ardhmes dhe aspekte frymëzuese

Pak me shumë se gjysma (57%) e të rinjve shprehen optimistë për të ardhmen, 1 në 10 nuk e ndan aspak këtë përjetim dhe të tjerët qëndrojnë të dyzuar në mes. Gjysma e të rinjve përjetojnë ndonjëherë ose deri në një farë mase pasiguri për të ardhmen e tyre. Frika dhe pasiguria për të ardhmen, përfshin rreth 2 në 10 të rinj ndërkohë që 3 në 10 deklarojnë se e refuzojnë ose nuk e përjetojnë këtë gjendje ose përjetim.

Djemtë deklarojnë si frikë kryesore të mos vazhduarit e shkollës që duan (mesatare e ulët), ose pamundësinë për të filluar një punë që ofron siguri të mjaftueshme financiare. Për më tepër zgjedhja e një profesioni të gabuar apo zgjedhja e një rruge të gabuar, qoftë nga shoqëria e keqe ose nga rrethana të tjera në jetë, është një frikë tjetër e djemve të rinj në qytetin e Elbasanit. Për vajzat, frika më e madhe lidhet me humbjen e familjes apo njerëzve të ngushtë dhe pamundësia për t'u edukuar në të ardhmen. Një pjesë e vajzave shprehin lirshëm gjatë diskutimit dëshirën dhe nevojën për siguri dhe mirëqënie financiare të cilën e lidhin drejtpërdrejtë me mirëqënien dhe sigurinë e tyre në jetë. Mbështetja familjare konsiderohet si një nga mënyrat më të mira për të kaluar frikërat dhe pasiguritë që ndjejnë për të ardhmen.

Figura 15



Përgjatë diskutimeve me të rinjtë, biseda sjell në vëmendje në mënyrë të përsëritur ndjesinë e pabarazisë që të rinjtë ndjejnë, projektuar më së shumti tek mundësitë dhe shanset për të ardhmen. Drejtësia – të marrësh atë që të takon, ose meritokracia, qoftë kjo në shkollë, në punë apo në shoqëri renditet e para ndër aspektet frymëzuese që mbush me besim për të ardhmen 40% prej tyre.

Mirëqënia ekonomike (sigurimi i kushteve më të mira ekonomike për familjen, mundësi të mira për punësim e për të bërë para) janë motivuesit kryesorë tek të rinjtë për një të ardhme më të mirë. Pavarësisht moshës së tyre kaq të re, siguria ekonomike është epiqendra e mendimeve dhe përjetimeve të tyre për të ardhmen, duke lënë në fokus dytësor çështje si mjedisi, emancipimi shoqëror, argëtimi, dashuria dhe zhvillimet teknologjike. Gati 1 në 3 të rinj frymëzohen dhe besojnë në një të ardhme më të mirë duke ndërtuar një familje, renditur pas ekonomisë familjare, parasë dhe punësimit. Zhvillimi ekonomik i vendit merr fokus nga 24% e të rinjve, ndërsa një qeverisje më e mirë dhe në interes të qytetarëve nga 17% prej tyre, pavarësisht se kjo e fundit mund të interpretohet më mirë, bashkangjitur me alternativën e drejtësisë dhe meritokracisë. 25% e të rinjve përzgjedhin si aspekte frymëzuese për një të ardhme më të mirë, një sistem më të mirë edukimi.


Figura 16



3.4 Mikro-mjediset që rrethojnë dhe ndikojnë adoleshentët

Familja, shoqëria/bashkëmoshatarët, shkolla/mësuesit dhe bota e artit, sportit e rrjetet sociale janë mikro-mjedise të rëndësishme që rrethojnë dhe ndikojnë zhvillimin e adoleshentëve.


Figura 17



Familja


Sikurse u përmend edhe më sipër, kalimi i kohës në familje është një aktivitet thelbësor në jetën e adoleshentëve (figura 2). Gjithashtu shumica e tyre (81%) ndjehen plotësisht të mbështetur për të ndërtuar të ardhmen që duan pikërisht nga familjarët e tyre (figura 15). Në grupet e diskutimit, ata tregojnë se si familja konsiderohet një nga mënyrat më të mira për të kaluar frikërat dhe pasiguritë që janë të natyrshme për moshën apo që ata kanë lidhur me shkollën apo situatën ekonomike. Ndërkohë që djemtë vetëdeklarojnë se familja ka më shumë rol këshillues pra, prindërit i këshillojnë se çfarë është e mirë dhe pastaj është në dorë të tyre ta ndjekin apo jo, vajzat e shohin familjen në rol këshillues, por edhe në rol detyrues, duke ju imponuar atyre një sërë sjelljesh apo zgjedhjesh. Prindërit, motrat dhe vëllezërit janë ata tek të cilët të rinjtë 14-15 vjeçarë kanë më shumë besim. Figura 18 tregon se nëntë nga dhjetë adoleshentë (90%) kanë besim të plotë tek prindërit dhe po aq (93%) shprehen se kanë besim të plotë tek motrat e vëllezërit. Kjo përmendet edhe në grupet e diskutimit, duke e veçuar familjen si “gjënë më të rëndësishme” për ta.

Figura 18



Anëtarët e familjes janë ata të cilët kanë më shumë ndikim tek të rinjtë dhe zgjedhjet e tyre. Gjashtë nga shtatë adoleshentë (85%) pohojnë se ndikohen shumë nga familja në zgjedhjet e tyre. Edhe në grupet e diskutimit, kjo grupmoshë shprehet se familja shërben si një burim frymëzimi për ta e që i mbush me energji pozitive e besim për të ardhmen.

Figura 19



Shoqëria

Të pyetur se çfarë ka rëndësi për ta personalisht, një në dy adoleshentë shprehen se të paturit një rreth të gjerë shoqëror dhe të qenit të pëlqyer nga shoqëria janë shumë të rëndësishme për ta (figura 20). Të paturit një rreth të gjerë shoqëror duket se konsiderohet si vlerë më shumë nga djemtë sesa nga vajzat. Më shumë se gjysma e djemve (56%) pranojnë se është shumë e rëndësishme për ta të kenë një rreth të gjerë shoqëror përkundrajt 39% të vajzave. Në grupet e diskutimit, të rinjtë pohuan se mendimet dhe shqetësimet për tema të caktuara janë më lehta e të pranueshme për t'u ndarë me shoqërinë sesa me familjarët. Sikurse u përmend edhe më sipër, kalimi i kohës me shoqërinë është një aktivitet tipik për adoleshentët (figura 2). Kjo mund të jetë një shëtitje në qytet apo një vizitë tek banesa e njëra-tjetrës për vajzat apo duke luajtur lojëra elektronike për djemtë, etj.

Figura 20



Tre nga gjashtë adoleshentë (60%) shprehen se kanë besim të pjesshëm dhe vetëm një në katër të rinj (26%) pohojnë se kanë besim të plotë tek bashkëmoshatarët. Djemtë kanë besim më të lartë sesa vajzat tek shokët, respektivisht 38% vs. 13%, ndërkohë që nuk ka dallime statistikore sipas gjinisë në lidhje me nivelin e besimit tek shoqet.

Figura 21



Nga ana tjetër, adoleshentët janë të dyzuar kur vlerësojnë ndikimin që ka shoqëria tek ata. Gjysma pohojnë se bashkëmosharët kanë shumë ndikim tek ata dhe zgjedhjet e tyre, kurse gjysma tjetër shprehet se ndikohen disi, pra më në një nivel më të ulët (figura 22). Sikurse debatohet edhe gjatë grupeve të diskutimit, niveli i ndikimit prej shokëve e shoqeve varion për shkak të disa faktorëve: (a) nga afërsia që mund të kenë p.sh. shokë të ngushtë ose jo; (b) nga përcaktimi i termit “ndikim” p.sh. ndryshimi i qëndrimit apo sjelljes bazuar tek këshillat ose presioni i drejtpërdrejtë nga shoqëria, etj. Megjithatë të rinjtë shpesh ndikohen në mënyrë të pavetëdijshme nga sjellja mes bashkëmoshatarëve në pëlqimet, sjelljet e aktivitetet e tyre. Gjinia është një faktor tjetër diferencues, kështu më shumë se gjysma e djemve (56%) vetëdeklarojnë se ndikohen shumë nga shoqëria përkundrejt dy ndër pesë vajzave (38%).

Figura 22



Mësuesit dhe shkolla

Ndikimi i stafit pedagogjik tek adoleshentët dhe zgjedhjet e tyre është i lartë. Sikurse tregohet në figurën 23, gjysma e 14-15-vjeçarëve në qytetin e Elbasanit (48%) pranon se mësuesit kanë ndikim të lartë tek ata dhe zgjedhjet e tyre, nivele këto të ngjashme me ndikimin nga shoqëria/bashkëmoshatarët. Argumentat e paraqitur në grupet e diskutimit hedhin dritë mbi perceptimet e tyre dhe fuqinë e mësuesve për t'i ndihmuar ata në përgatitjen akademike dhe si rrjedhojë, në profesionin ose zanatin e përzgjedhur dhe suksesin e tyre në të ardhmen.

Figura 23




Një e treta e të rinjve (34%) shprehen se kanë besim të plotë tek mësuesit, kurse gjysma e tyre (52%) ka disi besim, pra në një nivel më të ulët. Gjithsesi vetëm një në shtatë adoleshentë (14%) nuk kanë aspak besim tek mësuesit. Nivele të ngjashme besimi shfaqen edhe ndaj psikologëve e punonjësve socialë të shkollave. Diskutimet në grupe nxorën në pah se këto nivele besimi lidhen besueshmërinë dhe ekspertizën profesionale, por të rinjtë nuk janë të prirur t'u besojnë ndarjen e shqetësimeve ose problemeve personale. Nxënësit e klasave të 9-ta pjesëmarrës në fokus grupe shprehen se mund të ndajnë shumë rallë ndonjë problem me mësuesit, nëse çështja të lidhet drejtpërdrejt me shkollën. Por ata janë akoma më të distancuar nga psikologët që nuk konsiderohen si pika reference me të cilët mund të shprehin shqetësimet e tyre, duke nxjerrë në pah vështirësinë që ata hasin për ta kuptuar drejt e mirëpranuar rolin e psikologut shkollor.

Figura 24



Të pyetur mbi perceptimin e mësuesve në përgjithësi dhe përcaktimin e tyre si shembuj pozitivë ose negative, gjysma e adoleshentëve (53%) qartazi i perceptojnë mësuesit si shembuj më së shumti pozitivisht dhe vetëm një në njëzet të rinj (5%) i shohin mësuesit më së shumti si shembuj negativë.

Figura 25




Arti, sporti, rrjetet sociale dhe personazhet e famshme

Pothuajse të gjithë 14-15 vjeçarët në qytetin e Elbasanit (96%) përdorin rrjetet sociale, pavarësisht nga frekuenca ose sasia e kohës që ata shpenzojnë në këtë medium. Të pyetur mbi emrat konkretë të personazheve që ata ndjekin në rrjetet sociale, vihet re se 14-15 vjeçarët nga qyteti i Elbasanit ndjekin mesatarisht 5 personazhe nga kategori të ndryshme (muzika, televizioni, sporti, kinematografia, etj). Ndonëse pyetja ishte e fokusuar tek personazhet shqiptarë që ata ndjekin në rrjetet sociale, në mënyrë spontane dy të tretat e të rinjve (62%) kanë përmendur personazhe të famshme të huaja kryesisht nga bota e muzikës, sportit, kinematografisë e modelingut. Në diskutimet e hapura vihet re se personazhet e huaj vlerësohen më shumë se ata shqiptarë. Fusha e sportit veçanërisht dominohet nga figurat e huaja të futbollit, basketbollit dhe boksit si Lionel Messi, Cristiano Ronaldo, Kobe Bryant, LeBron James apo Mike Tyson. Ndër personazhet shqiptarë më i ndjekuri në rrjetet sociale nga një e treta e adoleshentëve të qytetit të Elbasanit (33%) është reperi Noizy, pasuar nga rivali i tij në muzikë Stresi, i cili ndiqen nga një në pesë adoleshentë (18%). Më tej, një në dhjetë adoleshentë shprehen se ndjekin në rrjetet sociale këngëtarin Ledri Vula (10%), kryeministrin aktual, Edi Ramën (12%) dhe moderatoren televizive, Bora Zemani (9%).

Figura 26

Rrjete sociale - Personazhet shqiptarë më të ndjekur



Personazhet nga bota e muzikës (kryesisht këngëtarët) janë kategoria më e ndjekur në rrjetet sociale, ndonëse individualisht jo në përqindje shumë të larta. Përpos Noizyt, Stresit e Ledri Vulës, një larmi emrash të tjerë këngëtarësh nga Shqipëria, Kosova e diaspora përmenden nga adoleshentët e Elbasanit sikurse ilustrohen në figurën 27. Ndërkohë numri i këngëtarëve të ndjekur në rrjetet sociale është akoma më i madh dhe i larmishëm, pasi ata i përkasin zhanreve të ndryshme, por kanë një popullaritet të kufizuar. Këtu përmenden Flori Mumajesi, Stealth, Miriam Cani, Arilena Ara, Rita Ora, Bebe Rexha, Era Istrefi, Aleksandër Gjoka, Dren Abazi, Beatrix e Alban Ramosaj, Ronela Hajati, Anxhela Persisteri, MC Kresha, Ava Max, Unikatil, Shkumbin Ismaili, Gjiko, Elgit Doda, Majk, 2 Ton, MatoLale, Tuna, Nora Istrefi, Sabiani, Poni, Ylli Baka etj., secili i ndjekur nga më pak se një në pesëdhjetë adoleshentë (2%).

Figura 27



Kategoria e dytë më e ndjekur është ajo e moderatorëve televizive si Bora Zemani apo Ermal Mamaqi (5%), Ardit Gjebrea (4%), Luana e Marina Vjollca (4% e 3% respektivisht), të cilët ndiqen në rrjetet sociale nga pothuaj një në njëzetë adoleshentë. Numri i moderatorëve të programeve televizive të ndjekur në rrjetet sociale është më i madh sesa paraqitja në figurën 28, por këta ndiqen nga më pak se 2% e të rinjve, si p.sh. Arbana Osmani, Alketa Vejsiu, Xhemi Shehu, Flori Ponari, etj.

Figura 28



Sportistë shqiptarë janë kategoria e tretë e personazheve të mirënjohur që ndiqen në rrjetet sociale nga kjo grupmoshë. Emrat individualë më të spikatur janë futbollistët Lorik Cana (6%), Armando Broja (4%) e Armando Sadiku (3%) dhe boksieri Florian Marku (5%). Sportisë të tjerë, kryesisht nga fusha e futbollit të cilët marrin vëmendjen e të rinjve ndonëse në një masë më të ulët janë Granit Xhaka, Thomas Strakosha, Etrit Berisha, Elseid Hysaj, etj (secili ndiqet nga më pak se 2%). Gjinia

është një faktor i rëndësishëm në këtë aspekt, pasi vihet re që sportistët ndiqen më tepër nga djemtë sesa nga vajzat.

Figura 29



Aktorët, kryesisht ata të programeve televizive humoristike në ekranet kryesore shqiptare, janë kategoria e katërt e personazheve të famshëm që ndiqen në rrjetet sociale, ndonëse pak prej tyre spikasin në mënyrë individuale si Florjan Binaj (3%) apo Bes Kallaku (4%) të cilët ndiqen nga përafërsisht një në njëzetë adoleshentë. Kolegët e tyre si Elvis Pupa, Olsi Bylyku, Agron Llakaj etj. kanë më pak popullaritet e ndiqen më rrallë në rrjetet sociale (secili nga më pak se 2% e 14-15 vjeçarëve në Elbasan).


Teksa të rinjtë pyeten se si i shohin politikanët, më shumë se gjysma (56%) i perceptojnë përgjithësisht negativë dhe vetëm 5% i shohin më së shumti si figura pozitive. Kjo shpjegon edhe pse politikanët kanë vëmendje të ulët dhe ndiqen rrallë në rrjetet sociale, me përjashtim të kryeministrit dhe drejtuesit aktual të Partisë Socialiste (Edi Rama). Politikanët e tjerë të të gjitha ngjyrimeve e pozitive, si Monika Kryemadhi, Grida Duma, Lulzim Basha, Sali Berisha, Gazmend Bardhi, etj. ndiqen në mënyrë të kufizuar, nga më pak se 2% e të rinjve.

Arsyet kryesore përse adoleshentët tërhiqen dhe i ndjekin figurat publike nëpërmjet llogarive në rrjetet sociale lidhen me dëshirën e tyre për të mësuar më shumë mbi talentin dhe rutinën profesionale të personazheve në fjalë, stilin e veshjes dhe mënyrën e tyre të jetesës. Megjithatë vihet re një qëndrim ndryshe kur flasin për personazhet shqiptare, të cilët me sa duket ndiqen më shumë për performancën e tyre (p.sh publikimi i këngëve më të reja, copëza nga klipet e tyre, etj.) se sa për jetën personale. Stili i veshjes rezulton të jetë ndër ndikimet më të mëdha që personazhet e mirënjohur kanë tek të rinjtë. Gjatë diskutimeve në grup, shumica e djemve dhe vajzave pranon që ata pëlqejnë të vishen sikurse VIP-at dhe ndjekin modën që ata prodhojnë, ndonëse më shumë i referohen personazheve të huaja, sikurse përmend ky djalë "Mua më ka pëlqyer që kur isha e vogël Justin Bieber dhe kam pasur qejf gjithnjë që të vishem si ai, duke e ndjekur si vishet".

Sikurse edhe e pritshme, të rinjtë kalojnë shumë kohë në rrjetet sociale dhe disa nga aktivitetet e tyre të preferuara lidhen me fushën e artit e sportit. Megjithatë, siç paraqitet në figurën 30, vetëm një e katërta e adoleshentëve (27%) shprehen se kinematografia dhe bota e artit ndikon shumë tek ata vetë dhe zgjedhjet e tyre, përkundrajt po kaq të rinjve (26%) të cilët shprehen se nuk ndikohen aspak. Nivele të ngjashme vihen re edhe kur flitet për ndikimin nga rrjetet sociale, kurse ndikimi i televizionit e medias është më i ulët teksa një në tre adoleshentë shprehen se nuk ndikohen aspak. Bazuar në vetdeklarimet e të rinjve, kinematografia, arti, media e rrjetet


sociale kanë ndikim më të ulët krahasuar me familjen, shoqërinë e madje edhe me shkollën e mësuesit.

Figura 30



Hulumtimi mbi perceptimin e personazheve të famshme në përgjithësi tregon se shkrimtarët dhe sportistët vlerësohen më shumë pozitivisht nga të rinjtë krahasuar me aktorët dhe muzikantët. Më konkretisht, gati treçereku i adoleshentëve (72%) mendon se shkrimtarët janë më së shumti pozitivë, tre nga pesë adoleshentë (62%) mendojnë këtë për sportistët dhe një në dy të rinj (49%) cilësojnë aktorët e muzikantët si shembuj më së shumti pozitivë (49%). Megjithatë duhet theksuar se vetëm 2% e të rinjve i shohin këto grupime si shembuj negativë. Vihet re se vajzat kanë një mendim më pozitiv për këngëtarët krahasuar me djemtë (55% e vajzave i shohin këngëtarët më së shumti pozitivisht krahasuar me vetëm një në tre djem ose 34%).

Figura 31




3.5 Figurat modelet sipas këndvështrimit të 14-15 vjeçarëve

Përcaktimi dhe karakteristikat e figurës model ose shembullit të mirë

Të pyetur se çfarë nënkupton për ta një figurë model ose shembull i mirë, një e treta e të rinjve shprehen se është dikush që përfshin një sërë dimensionesh – dikush që kërkon të ndihmojë të tjerët e ju qëndron pranë atyre, që respektohet nga të tjerët e admirohet për veprimet e suksesin dhe me një personalitet të denjë për t'i ngjarë. Vajzat duken më kërkuese krahasuar me djemtë në këtë përcaktim të figurës model. Rreth dy në pesë vajza (38%) shprehen se shembujt duhet t'i përfshijnë të gjitha këto dimensione përkundrejt një në katër djem (27%).


Nga këto dimensione, duket qartazi që ndihma ndaj të tjerëve dhe veprat e mira është dimension i kryesor që i vetëm përcakton një figurë model ose shembull të mirë sipas një në pesë adoleshentëve (22%). Një në shtatë adoleshentë e përkufizojnë figurën model si dikë që ka një personalitet të denjë për t'u imituar. Ky mendim është dy herë më i lartë tek djemtë sesa tek vajzat (18% përkundrejt 8%). Nga ana tjetër, vetëm një në dhjetë adoleshentë (9%) e përkufizojnë figurën model si dikë që ju qëndron pranë e kujdesit për ta. Po kaq (8%), janë edhe ata adoleshentë që e përkufizojnë figurën model si dikush që admirohet për veprimet e tij/saj dhe suksesin e arritur. Kjo tregon se këto dy dimensione – kujdesi i drejtëpërdrejtë dhe sukcesi kanë më pak peshë në përcaktimin e figurës model për adoleshentët e qytetit të Elbasanit.

Figura 32



Sipas gjysmës së adoleshentëve, karakteristika kryesore e figurave model është që ata frymëzojnë të tjerët për të kryer vepra të mira gjithashtu. Më tej, dy nga pesë të rinj vlerësojnë të qenit të ndershëm, inteligjentë e që punojnë fort dhe janë të suksesshëm në profesionin e tyre si karakteristika parësore të figurave model. Ndërkohë për vajzat këto cilësi kanë më shumë rëndësi sesa për djemtë. Më shumë se gjysma e vajzave (57%) shprehen se shembujt duhet të frymëzojnë njerëzit të bëjnë gjëra të mira përkundrejt 44% e djemve. Gjithashtu, gjysma e vajzave (47%) besojnë se figurat model janë ato që punojnë shumë përkundrejt 34% e djemve. Sikurse paraqitet në figurën 33, një në dhjetë adoleshentë cilësojnë se pamja e jashtme, fama dhe paratë janë karakteristika tek figurat model, por renditja e tyre na tregon se këto nuk janë parësore. Gjithsesi për djemtë këto cilësi kanë më shumë rëndësi sesa për vajzat. Një në pesë djem (18%) shprehen se figurat model për ta duhet të kenë shumë para përkundrejt vetëm një në katërmbëdhjetë vajza (7%).


Figura 33



Në grupet e diskutimit, djemtë e vajzat theksojnë se origjinaliteti, vetëbesimi, forca e brendshme për t'u përballur me përpjekjet e jetës, qëndrimet e sjelljet pozitive ndaj të tjerëve, përulesia janë disa karakteristika që veçojnë figurat shembull. Interesante është që vajzat e theksojnë më fort origjinalitetin – të qenit vetvetja sesa djemtë si një karakteristikë të rëndësishme tek figurat model dhe gjithashtu, si një tipar që ato vetë dëshirojnë ta zotërojnë personalisht.

Figura 34

Karakteristika e figurave model që i bën ata shembull...me fjalët tona



"Figura model duhet të jetë pozitiv, të ketë stil, të jetë i veçantë, të përcjellë mesazhe e këshilla... të tregojë se çfarë ka kaluar në jetë, të tregojë se si e ka arritur suksesin dhe të bëhet i famshëm"

"Shembulli i mirë është dikush që nuk bullizon, nuk diskriminon por që ka një mentalitet të hapur"


"Një këngëtar mund të na ndikojë pozitivisht nëse na tregon rrugëtimin që ka bërë për të arritur aty ku është dhe të na nxisë që edhe ne të bëjmë të njëjtën gjë"

"Për mua ky është dikush i cili respekton veten dhe të tjerët. Ka vetëbesim dhe synime për të ardhmen dhe lufton për to duke mos i lënë thjesht e vetëm ëndrra, por duke i kthyer në qëllime për t'u arritur"

Cilat janë figurat model ose shembujt e mirë për adoleshentët e Elbasanit


Gjetjet e këtij studimi, tregojnë se adoleshentët identifikojnë mesatarisht dy figura model ose shembuj, së pari nga mikro-mjediset e jetës së tyre reale si familja, të afërmit, shoqëria ose profesionistët në komunitetin e tyre, e më pas nga figurat publike në fushën e muzikës, sportit, medias, shkencës apo biznesit. Kjo grupmoshë veçon ndjeshëm anëtarët e familjes si figura model, më shumë sesa nga çdo mikro-mjedis tjetër. Pas familjes, është bota e artit, muzikës, letërsisë, media (27%), sportit (10%), dhe rrjetet sociale (10%) ajo që ofron mikro-mjedisin e dytë ku adoleshentët identifikojnë figurat model. Vajzat kanë si figura model më shumë personazhe të famshme nga bota e artit, muzikës e letërsisë sesa djemtë (36% vs. 17%), kurse djemtë kanë më shumë figura model mes sportistëve sesa vajzat (15% vs.6%).

Figura 35




Sikurse vihet re në figurën 35, katër nga pesë adoleshentët e qytetit të Elbasanit kanë cilësuar se familjarët janë shembujt ose figurat model për ta, me një diferencë të thellë ndaj personazheve të famshëm e grupimeve të tjera. Më specifikisht, dy nga pesë adoleshentë cilësojnë mamanë ose babanë (respektivisht 40% dhe 42%) si modelin e tyre dhe kjo, sepse i vlerësojnë për sakrificat ose arritjet profesionale, por edhe sepse prindërit i duan pa kushte, ju duan më të mirën dhe i mbështesin në rrugëtimin e tyre. Motrat dhe vëllezërit shikohen gjithashtu si modele, respektivisht nga 29% dhe 18% e 14-15 vjeçarëve (figura 36).

Figura 36



Më pak se një në pesë të rinj kanë gjyshërit si figurat model ose shembujt e tyre dhe më konkretisht, 18% cilësojnë gjyshen dhe 15% gjyshin. Familja e zgjeruar ose dikush në rrethin e afërt shikohet gjithashtu si burim për figurat model nga në një pesë adoleshentë (18%) dhe më konkretisht, një në dhjetë cilësojnë kushërinjtë (10%) e po aq dajet ose xhaxhallarët (9%) dhe tezet ose hallat (8%).

Figura 37



Shoqëria është e rëndësishme në këtë moshë, por vetëm një në gjashtë të rinj (16%) cilësojnë shoqet ose shokët si figurë model për ta. Kjo mund të shpjegohet me faktin që karakteristikat e përmendura për këto figura (si p.sh. të qenit të suksesshëm, të respektuar nga komuniteti, etj) përgjithësisht kërkojnë kohë të zhvillohen dhe gjenden më shumë tek të rriturit sesa tek

bashkëmoshatarët. Meshkujt ka më pak gjasa të cilësojnë shokët si shembuj krahasuar me vajzat të cilat cilësojnë tre herë më shumë se djemtë shoqet e tyre si figura model për to.

Ndër profesionistët që i rrethojnë në komunitet, mësuesit veçohen si figura model për një në dhjetë nxënës të kësaj moshe (10%), pasuar nga mjekët (4%). Kjo është e kuptueshme, duke qenë se këto janë edhe dy profesionet me të cilat adoleshentët mund të jenë më shpesh në kontakt dhe të cilat, sikurse vihet re në figurën 38, vlerësohen më së shumti pozitivisht (64% mjekët dhe 53% mësuesit). Disa përmendin si figura model mësuesit kujdestarë apo mësues të lëndëve specifike (matematikë, letërsie, edukimi fizik, etj.), mjekët e familjes ose të tjerë të cilët ju kanë shpëtuar jetën prindërve ose personave të dashur për të rinjtë.

Gjatë grupeve të diskutimit, të rinjtë u shprehën se edhe një person i suksesshëm në një profesion të caktuar ose në profesionin që ata duan të ndjekin, mund të shërbejë fare mirë si model për ta. Zjarrfikësit janë një profesion i vlerësuar masivisht si pozitivë nga tre të katërtat e të rinjve, megjithatë ata nuk përmenden si figura model. Vlerësimi i lartë mund të shpjegohet me perceptimin që ky profesion mishëron dimensionin kryesor të një shembulli - ndihmën ndaj të tjerëve, por edhe me ndikimin e filmave hollivudianë ku zjarrfikësit janë personazhe heroikë. Nga ana tjetër, mospërmendja e tyre si figura model nga adoleshentët, me shumë gjasa është e ndikuar nga numri i kufizuar i këtyre profesionistëve në qytetin e Elbasanit dhe kontaktin e limituar që të rinjtë kanë me ta në jetën reale.


Figura 38



Sipërmarrësit e suksesshëm e sidomos ata që zotërojnë kompani me mbulim ndërkombëtar përmenden si shembuj nga kjo grupmoshë. Prej tyre veçohet Elon Musk si figurë model për një në njëzetë adoleshentë të qytetit të Elbasanit (5%), pasuar si nga emra të tjerë si Bill Gates, Jeff Bezos, Mark Zuckerberg, Steve Jobs etj. (secili <2%), kurse sipërmarrësit shqiptarë si p.sh. Samir Mane, përmenden rrallë (më pak se 1%).

Më shumë se gjysma e adoleshentëve të qytetit të Elbasanit cilësojnë si shembull dikë nga bota e muzikës, qofshin këta këngëtarë shqiptarë apo të huaj, kurse një në pesë cilësojnë si të tillë një aktor/e. Ndërkohë, një e katërta e adoleshentëve gjejnë figura model mes sportistëve të huaj e shqiptarë. Këtu veçohen dy futbollistët me famë botërore, Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi, të cilët janë shembuj për këtë grupmoshë respektivisht tek 5% dhe 4% e tyre. Vetëm një në dhjetë adoleshentë shprehen se kanë një shkrimtar/e si figurë model dhe emri i vetëm i spikatur është Ismail Kadare, ndonëse edhe ky nga një numër i kufizuar të rinjsh (2%).

Figura 39



Ndonëse, këngëtarët shqiptarë ishin shumë të ndjekur në rrjetet sociale ata janë ndjeshëm më pak të konsideruar si figura model dhe sërish, tre figurat e përmendura më shumë janë këngëtarët shqiptarë, Noizy (8%), Stresi (5%) dhe Tayna (4%). Kjo shpjegohet edhe me faktin që të rinjtë besojnë se të qenit i famshëm apo në një pozitë të rëndësishme nuk është në korrelacion të drejtë me të qenit model pozitiv dhe edukues për të tjerët. Sikurse debatojnë në grupet e diskutimit, ata diferencojnë të ashtuquajturit VIP-a shqiptarë duke u shprehur se nuk i konsiderojnë si shembuj pozitivë për shkak të arrogancës, injorimit të fansave, shembujve negativë që shfaqin në videoklipet e tyre etj. në ndryshim nga personazhet me famë botërore për të cilët shfaqin më shumë vlerësim pozitiv.

Figura 40

Personazhet e mirënjohur si figura model ...me fjalët tona

“Që të jenë shembuj duhet të kenë ndikim të mirë. Po të isha unë VIP, nuk do të jepja shembull të keq, që të shaja apo të bëja video me drogë e armë, sepse shohin edhe 8-vjeçarë që duan të bëhen si Finemi me pistoletë etj.”

“Këto të “Për’puthen” nuk janë VIP-a, por janë bërë të famshëm le të themi. Janë dy fjalë të ndryshme ‘VIP’ dhe ‘i famshëm’. Të jesh VIP dhe shembull për të tjerët, ai person duhet të ketë autoritetin e vet, të jetë i drejtë, të menaxhojë sjelljet e veta në publik”

“Kam parë që Cristiano Ronaldo apo Xhensila Myrtezaj i injorojnë shumë fansat e tyre, i shtyjnë e i largojnë njerëzit kur tentojnë t’ju afrohen. Këto nuk janë shembuj pozitivë.”




Ndikimi i figurave model në jetën e adoleshentëve

Të pyetur se si ndikojnë figurat e ndryshme model që ata kanë tek vetë adoleshentët, gjysma e tyre shprehen se ndikohen nga këta shembuj mbi çështje si përzgjedhja e shkollës dhe profesionit të ardhshëm, aktivitetet e interesat që praktikojnë, si dhe sjelljen me shoqërinë. Kjo është e kuptueshme duke konsideruar se prindërit janë dy figurat kryesore model për shumicën e adoleshentëve të qytetit të Elbasanit. Ndërkohë, dy nga pesë adoleshentë vetëdeklarojnë se ndikimi i figurave model tek kujdesi personal dhe stili i veshjes e paraqitja e jashtme. Kjo është po aq e lidhur me figurat model që janë gjithashtu personazhe të famshëm e të suksesshëm, sa edhe me shembujt nga familja. Në grupeve të diskutimit, kryesisht vajzat shprehen se figurat model ndikojnë gjithashtu tek nivelet e vetëbesimit apo tek sjellje të caktuara që ato shfaqin, sikurse përmend një prej tyre “Unë për shembull kam parë G-Banin që ndihmonte njerëzit në rrugë dhe fillova dhe unë t’i ndihmoj njerëzit në rrugë”.

Figura 41

Ndikimi i figurave model tek adoleshentët



KAPITULLI IV – REKOMANDIME

Nxënësit e klasave të 9-ta në qytetin e Elbasanit kanë pasione të ngjashme me ato të adoleshentëve të tjerë, por ata hasin vështirësi të ndryshme për shkak të mjedisit ku jetojnë dhe problematikave më të gjera që lidhen me situatën social-ekonomike në qytetin e tyre. Të përballur me mungesën e sigurisë dhe infrastrukturës së pamjaftueshme shkollore, ata devijojnë prioritetet nga dëshirat tipike të moshës tek kërkesa më bazike e ekzistenciale. Të rritur në një mjedis me paragjykime e diskriminim, të ndikuar nga media sociale dhe ajo tradicionale ku shpesh fokusi është në ngjarje negative ose personazhe që nuk transmetojnë vlera, ata në fakt kanë nevojë për shembuj pozitivë dhe figura frymëzuese për t'i ndihmuar të zhvillohen në mënyrë të shëndetshme dhe të identifikojnë motive për t'u ndërtuar të ardhmen në vendin e tyre. Më poshtë paraqiten disa rekomandime të mbështetura në gjetjet e këtij studimi.

Edukojini të rinjtë se stereotipet gjinore që kufizojnë vajzat dhe ngushtojnë potencialin e tyre duhen tejkaluar nga brezi i ri për të krijuar një realitet më të shëndetshëm për vajzat, djemtë dhe bashkëjetesën midis tyre. Fushatat edukuese gjinore është mirë që të punojnë të paktën në dy fronte. Fuqizimimi dhe inkurajimi i vajzave për të kapërcyer kufizimet sociale dhe edukative me shembuj konkret frymëzues. Së dyti, duhet punuar me të dyja gjinitë për informimin, sensibilizimin dhe rritjen e empatisë kundrejt vajzave të trafikuar ose me histori dhune apo ngacmimesh të ndryshme. Mbrëmjet filmike me filma ose dokumentarë mbi tematikat e mësipërme mund t'i ndihmojnë të rinjtë të ulin paragjykimet, të zgjerojnë arsyetimet e tyre mbi kompleksitetin e arsyeve të viktimave dhe rrisin mbështetjen kundrejt tyre apo ndërhyrjen në raste potenciale.

Mbështetini të rinjtë të organizohen në grupe letrare apo mbrëmje poetike, që e nxjerrin letërsinë dhe leximin nga privatësia e shtëpisë për ta përdorur atë si katalizator të promovimit të modeleve të ndryshme frymëzuese nga ai që ofron realiteti përreth. Për hir të ringritjes së imazhit të leximit, këto aktivitete do ishte mirë të organizoheshin dhe promovoheshin nga vetë të rinjtë pa përfshirjen e dukshme të të rriturve, për të forcuar imazhin e letërsisë dhe leximit si një aktivitet rinor. Ndhimjoni të rinjtë, nëpërmjet profesionistëve të fushës, të përzgjidhin një seri titujsh biografik, histori frymëzimi dhe tejkalmimi të realitetit, për t'i promovuar mes tyre dhe bërë pjesë të aktiviteteteve letrare.

Krijoni një fushatë bashkëpunimi me policinë e qytetit për të stimuluar besimin e të rinjve tek policia dhe për t'i informuar ata mbi mënyrat e kontaktit të strukturave policore, metodat dhe procedurat që duhet të ndjekin, pritshmëritë mbi procesin, rastet e nevojshme dhe ndihma që përfitojnë. Duke ftuar një çift policësh, të flasë në çdo klasë dhe shkollë për këto tema, çmitizojmë frikën ndërsa shtojmë besimin tek policia si aleate e tyre në qytet.

Duke pasur parasysh se adoleshentët cilësojnë më shumë si figura model të rritur që janë prezent në jetën e tyre të përditshme (në krahasim me atletët ose personazhe të tjerë të famshëm nga bota e artit dhe medias), është jetike që anëtarët e rritur të familjes dhe të rriturit që ndërveprojnë shpesh me të rinjtë të modelojnë sjellje prosociale. Për këtë arsye, mund të zhvillohen aktivitete që promovojnë sjelljen e përgjegjshme tek të rriturit (prindër, mësues, mjekë, etj.). Gjithashtu, mund të zhvillohen aktivitete ose projekte komunitare që ndihmojnë adoleshentët të lidhen me të rriturit në

komunitetet e tyre duke shtuar shanset që ata të ekspozohen ndaj të rriturve që modelojnë sjelljen prosociale.

Lartësoni prindërit si figurat model përmes aktiviteteve prezantuese në klasë ose rrjetet sociale. Ftoni prindërit të prezantojnë veten e të flasin për përzgjedhjen e profesionit/zanatit, pengesat e tejkaluara në jetë dhe arritjet e tyre në jetën personale e profesionale. Respektoni të gjithë prindërit pa dallim nga profesioni apo fama e tyre.

Zhvilloni biseda argumentuese me adoleshentët në lidhje me personazhet e mirënjohur e të përmendur në media e rrjetet sociale. Ndhimojini ata të diferencojnë bujën mediatike nga përmbajtja e personazhit. Lejoni pa paragjykime të shprehin pëlqimet e tyre dhe ngrini diskutime mbi famën, paranë, dilemat morale etj.

Organizoni aktivitete me të rinjtë ku të ftoni profesionistë të respektuar si zjarrëfikës, mjekë, mësues, shkrimtarë, sportistë, këngëtarë, etj. ku ata të flasin më shumë për të bukurat, sfidat dhe të rejtat e fushës së tyre, të ndajnë histori frymëzuese për tejkalimin e pengesave dhe suksesin. Sugjerohen aktivitete në grupe të vogla (numër i kufizuar të rinjsh) duke ju dhënë mundësinë atyre të drejtojnë pyetje e marrin përgjigje.

Mbulim mediatik i shtuar i sjelljes pozitive të të rriturve do të inkurajonte të rriturit të përfshihen në sjellje prosociale, por do të rrist gjithashtu ekspozimin e adoleshentëve ndaj sjelljeve pozitive të të rriturve në jetën e përditshme. Bashkëpunoni me televizionet dhe mediat sociale për të sjellë programe të dedikuara për të rinjtë duke u fokusuar tek promovimi i modeleve pozitive në mes tyre, ndërgjegjësimi për çështje si bullizmi, barazia gjinore etj., por duke u fokusuar edhe tek mësimi i aftësive jetësore e zakone të shëndetshme, të tilla si shprehja e vetvetes, vetëmenaxhimi, ndjeshmëria/empatia dhe miqësia.

ANEKSE

ANEKSI A – LISTA E FIGURAVE

| Figura nr. | Emërtimi i figures | Nr. fq. |
|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| Figura 1 | Shpërndarja e kampionit sipas shkollave 9-vjeçare dhe gjinisë | 14 |
| Figura 2 | Aktivitete familjare dhe shoqërore | 15 |
| Figura 3 | Aktivitete lidhur me teknologjinë | 16 |
| Figura 4 | Aktivitete sportive, artistike dhe të tjera | 17 |
| Figura 5 | Aktivitete të tjera: media, letërsi, fe | 18 |
| Figura 6 | Përmirësime për të rritur cilësinë e jetës së të rinjve në Elbasan | 19 |
| Figura 7 | Komente kualitative mbi nevojat e të rinjve për ambiente dhe aktivitete | 19 |
| Figura 8 | Vlerat e përçafuara nga të rinjtë | 20 |
| Figura 9 | Shqetësime që të rinjtë përjetojnë në jetë dhe frekuenca e tyre | 22 |
| Figura 10 | Gjykimi mbi sjellje të ndryshme të hasura në shoqëri | 23 |
| Figura 11 | Faktorët e diskriminimit mes të rinjve dhe frekuenca e dukurisë | 24 |
| Figura 12 | Përfshirje në konflikt verbal apo fizik, në vetë të parë | 25 |
| Figura 13 | Planet e të rinjve në përfundim të arsimit 9-vjeçar | 26 |
| Figura 14 | Synimi për ta ndërtuar të ardhmen jashtë Shqipërisë | 26 |
| Figura 15 | Projektme dhe përjetime rreth të ardhmes | 27 |
| Figura 16 | Aspekte frymëzuese që mbushin me besim për një të ardhme më të mirë | 28 |
| Figura 17 | Mikro-mjediset dhe ndikimi i tyre tek adoleshentët në qytetin e Elbasanit | 29 |
| Figura 18 | Niveli i besimit tek familja dhe të afërmit | 30 |
| Figura 19 | Ndikimi i familjes tek të rinjtë dhe zgjedhjet e tyre | 30 |
| Figura 20 | Rëndësia e shoqërisë tek adoleshentët | 31 |
| Figura 21 | Niveli i besimit tek shoqëria | 31 |
| Figura 22 | Ndikimi i shoqërisë tek adoleshentët dhe zgjedhjet e tyre | 32 |
| Figura 23 | Ndikimi i mësuesve tek adoleshentët dhe zgjedhjet e tyre | 32 |
| Figura 24 | Niveli i besimit tek mësuesit | 33 |
| Figura 25 | Perceptimi mbi figurën e mësuesit në përgjithësi | 33 |
| Figura 26 | Personazhet shqiptarë më të ndjekur në rrjetet sociale | 34 |
| Figura 27 | Këngëtarët shqiptarë më të ndjekur në rrjetet sociale | 35 |
| Figura 28 | Moderatorët televizivë shqiptarë më të ndjekur në rrjetet sociale | 35 |
| Figura 29 | Sportistët shqiptarë më të ndjekur në rrjetet sociale | 36 |
| Figura 30 | Ndikimi i artit, medias dhe rrjeteve sociale tek adoleshentët | 37 |
| Figura 31 | Perceptimi mbi profesionistë nga bota e artit dhe sportit | 37 |
| Figura 32 | Përkufizimi i figurës model / shembullit të mirë sipas adoleshentëve të Elbasanit | 38 |
| Figura 33 | Karakteristikat e figurave model, ç'ka i bën ata shembull | 39 |
| Figura 34 | Komente kualitative mbi karakteristikat e figurave model | 39 |
| Figura 35 | Figurat model ose shembujt e të rinjve të qytetit të Elbasanit | 40 |
| Figura 36 | Familja dhe fisi, si mikro-mjedisi kryesor ku gjenden figurat model për adoleshentët e qytetit të Elbasanit | 41 |
| Figura 37 | Komente kualitative mbi familjarët si figurat model | 41 |
| Figura 38 | Perceptimi mbi profesionistë të ndryshëm në shoqëri | 42 |
| Figura 39 | Personazhet e famshme - figurat model për adoleshentët e qytetit të Elbasanit | 43 |
| Figura 40 | Komente kualitative mbi personazhet e famshme si figura model | 43 |
| Figura 41 | Ndikimi i figurave model tek adoleshentët e qytetit të Elbasanit | 44 |

ANEKSI B – UDHËRRËFYESI PËR FOKUS GRUPET ME DJEM E VAJZA

Hyrje

- Prezantimi i organizatës INAC dhe moderatorit
- Prezantimi i pjesëmarrësve
- Rregullat e diskutimit

Jeta personale dhe sociale

1. Mund të përshkruani një ditë të zakonshme tuajën – cila është rutina, aktivitetet tuaja (java vs. fundjava)?
2. Si e kaloni kohën e lirë ... pra çfarë aktivitetesh bëni në shtëpi ose jashtë kur nuk jeni duke mësuar? Cilat janë aktivitetet tipike që bëni me miqtë tuaj (shokët e klasës, të lagjes, etj.)?
3. A mendoni se ka diferenca midis grupmoshës tuaj në qytetin e Elbasanit dhe grupmoshës tuaj në rrethe të tjera ose në fshat?
4. A ka ndonjë fushë që ju intereson veçanërisht – hobi / pasion (muzika, sporti, fotografia, lojëra elektronike, teknologji, leximi, etj.)? Po ju vetë, a praktikoni praktikoni ndonjë sport, luani ndonjë vegël muzikore, këndonit ose kompozoni, etj.?
5. A ndjeni se ka mungesa në drejtim të aktiviteteve jashtëshkollore për të rinjtë e moshës tuaj?

Të rinjtë 14-15 vjeç shqetësimet dhe interesat e tyre

Kur mendoni për të rinjtë e moshës tuaj (14-15 vjeçarët në Elbasan / Shqipëri)...

6. Cilat mendoni se janë shqetësimet apo sfidat kryesore me të cilat përballen 14-15 vjeçarët shqiptarë? Po ata në Elbasan specifikisht?
7. Cilat janë çështjet më prioritare për të cilat shkolla, familja, qeveria, shoqëria shqiptare duhet të fokusohet më shumë kur vjen fjala tek brezi juaj?
8. Cilat janë tre gjëra që ju interesojnë / që ju keni për zemër (ju dhe /ose bashkëmoshatarët tuaj)?
9. Cilat janë ato gjëra që ju frymëzojnë dhe ju karikojnë me energji pozitive?
10. Cilat janë ato gjëra që ju fikin shpresat ose ju ulin energjinë pozitive?
11. Cilat janë tre gjëra që dëshironi të ndodhin në të ardhmen tuaj? A mendoni se këto janë të realizueshme? Çfarë mund t'ju pengojë t'i realizoni këto?
12. Cilat janë tre gjëra që druani / keni frikë se mund të ndodhin në të ardhmen tuaj? A mendoni se këto janë frikëra realiste – pra sa gjasa ka të ndodhin? Çfarë mund t'ju ndihmojë t'i tejkaloni këto frikëra?

Arsimi

Le të flasim pak për shkollimin tuaj aktual dhe në të ardhmen.

13. Si ndjeheni me shkollën tuaj - si e vlerësoni ecurinë tuaj akademike? Si ndjeheni me klasën, mësuesit, atmosferën e përgjithshme?
14. Çfarë mendoni se do të bëni pas një viti / ku do të jeni? A keni menduar se çfarë gjimnazi do të ndiqni – të përgjithshëm ose profesional (apo do ta ndërprisni shkollimin) dhe përse – cilat janë arsyet?
15. Çfarë mendoni se do të bëni pas 4-5 viteve? Çfarë dëshironi të bëheni / bëni në jetë pas përfundimit të shkollës së mesme dhe përse?
16. PËR ATA QË DO TË NDJEKIN UNIVERSITETIN: Cilat janë kriteret sipas të cilave ju përzgjidhni të ndiqni një degë apo universitet të caktuar (përtej publik / privat, në Shqipëri / jashtë)? Përse universitet publik ose privat / studime në Shqipëri ose jashtë?

17. Sa ndikim ka në jetën dhe zhvillimin e të rinjve si ju (14-15 vjeçarë) shkolla, familja, shoqëria, qeveria, media? Cila ndikon më shumë e cila më pak?
18. Po roli i vetë të rinjve cili është? A mund të ndikoni ju tek vetja apo bashkëmoshatarët më shumë e më pozitivisht për zhvillimin e tyre?
19. Me kë i ndani mendimet dhe shqetësimet tuaja: prindërit dhe familjen, shokët e shoqet, mësuesit, psikologët ose punonjësit socialë në shkollë etj.

Rrjetet sociale

20. Ju personalisht, keni hapur llogarinë tuaj në rrjetet sociale dhe në cilat prej tyre: Facebook, Instagram, TikTok, Snapchat, Pinterest, YouTube, Ëhatsapp, etj.?
21. Zakonisht sa kohë shpenzoni gjatë një dite duke përdorur rrjetet sociale dhe për çfarë i përdorni rrjetet sociale ?
22. Cilët janë personazhet e famshëm (VIP) që ju ndiqni në rrjetet sociale (dmth keni bërë like / folloë). Përse pikërisht këta? A ndiqni zhvillimet e tyre profesionale apo ju intereson jeta personale?
FOKUSOHU TEK FIGURAT SHQIPTARE
23. Sa të ndikuar ndjeheni nga zgjedhjet e tyre psh për stilin e veshjes, aktivitetet, përzgjedhjen tuaj për shkollën ose universitetin, etj...?

Figurat model / shembujt

24. Sipas mendimit tuaj çfarë është një figurë model ose shembull? Si do ta përkufizonit?
25. Çfarë karakteristikash kanë këta njerëz që i bën ata shembull për ju? Çfarë admironi tek këto figura?
26. Cilat janë figurat model për ju?
27. Si ndikojnë këto figura model në sjelljen tuaj dhe për çfarë ...psh zgjedhjet tuaja për veshjen, përdorimin ose jo të tualetit, zgjedhja për shkollimin ose profesionin/zanatin në të ardhmen etj.?
28. A dëshironi t'i ngjani këtyre figurave? Kujt specifikisht dhe në cilat aspekte? Përse?
29. Nqse do mund të zgjidhnit cilët prej këtyre figurave shqiptare do të donit të takonit?
30. Çfarë aktiviteti mund të sugjeroni? A mendoni se bashkëmoshatarët tuaj do ta pëlqenin këtë aktivitet / këtë personazh? A do të merrnin pjesë ata? Përse?
31. Po ju vetë, si mendoni, çfarë duhet të bëni ju për t'u bërë figurë model për dikë tjetër?
32. Mendoni për figura të cilat nuk i respektoni / nuk i vlerësoni pozitivisht. Cilët janë (emra – kategoria)? Përse nuk i respektoni – arsyet? Cilat janë karakteristikat që nuk i vlerësoni pozitivisht? FOKUSOHU TEK SHQIPTARËT

Shembuj jo pozitivë mes të rinjve

Duke menduar për të rinjtë që përfshihen në aktivitete ose sjellje të papëlqyeshme p.sh që përfshihen në aktivitete si vjedhja, konsumi i alkoolit apo drogës, etj.

33. Cilat janë disa problematika që ju vini re – sjellje të tilla si zënka fizike mes bashkëmoshatarëve, vandalizmi në shkollë (dëmtimi i objekteve, zënka me mësuesit, etj.), armët në shkollë, angazhimi në grupe – mashtrimi, vjedhje, etj...?
34. Përse mendoni se të rinjtë angazhohen në këto sjellje? Cilët janë faktorët (varfëria, janë të detyruar nga më rriturit, etj.) A janë të shumtë këta në shoqëri?
35. A jeni të frikësuar prej tyre? Përse po/jo?
36. A tentojnë këta të rinj të përfshijnë edhe bashkëmoshatarë të tjerë në këto sjellje (me ose pa dëshirë)?
37. Nqse këta të rinj përpiqen t'ju përfshijnë ose t'ju detyrojnë, kujt mund t'i drejtoheni për ndihmë? A është e mundur t'ju ndihmojnë psh prindërit, shoqëria, mësuesit, policia, etj.?

[PËR GRUPIN E VAJZAVE]

38. Sa të rrezikuara mendoni se janë vajzat e moshës tuaj nga ngacmimet në rrugë ose shkollë apo trafikimi? Përse?
39. Nëse ndjeheni të rrezikuara, a keni dijeni se ku mund të kërkoni ndihmë? Tek kush keni besim se mund t'ju ndihmoj dhe pse?
40. A ka diçka tjetër që do donit ta shtoni në lidhje me temat që diskutuam – ndonjë mendim ose koment të fundit, ndonjë sugjerim?

Falenderime dhe mbyllje e diskutimit!

ANEKSI C – PYETËSORI SASIOR ME TË RINJTË E KLASAVE TË 9-TA NË QYTETIN E ELBASANIT

Shoqata INAC (Information Network and Active Citizenship) është duke hulumtuar shqetësimet dhe aspiratat e të rinjve të moshës suaj, për të sjellë në vijim, aktivitete rinore në ndihmë të komunitetit. Ky pyetësor duhet plotësuar vetëm nga nxënësit e klasave të 9-ta në qytetin e Elbasanit. Ju ftojmë të jepni opinionin tuaj anonim nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme që do t'ju marrin rreth 15 minuta kohë. Ju lutem plotësoni çdo pyetje dhe në fund klikoni butonin "U krye!" Ju mund ta ndërprisni plotësimin e këtij pyetësori, sa herë të dëshironi dhe t'i riktheheni sërish më vonë duke ndjekur link që keni marrë.

Për çdo paqartësi apo pyetje mund të kontaktoni në: e-mail: inacalbania@gmail.com tel: +355695688008

P.1 Cila është gjinia jote?

| |
|----------|
| Femër |
| Mashkull |

P2. Në cilën shkollë 9-vjeçare studjon?

| |
|-------------------------------|
| Shkolla Fadil Gurmani |
| Shkolla Hamit Mullisi |
| Shkolla Qamil Guranjaku |
| Shkolla Adem Krasniqi |
| Shkolla Qemal Haxhihasani |
| Shkolla Sule Harri |
| Shkolla Ptolome Xhuvani |
| Shkolla Jeronim De Rada |
| Shkolla Sul Misiri |
| Shkolla Abdyl Paralloi |
| Shkolla Sule Domi |
| Shkolla Jorgji Dilo |
| Shkolla Naim Frasheri |
| Shkolla Bardhyl Popa |
| Shkolla Ali Agjah |
| Shkolla Luigj Gurakuqi |
| Tjetër (PYETËSORI NDËRPRITET) |

P3. Në cilën klasë studion aktualisht?

| |
|---------|
| Klasa 8 |
|---------|

| |
|-------------------------------|
| Klasa 9 |
| Tjetër (PYETËSORI NDËRPRITET) |

P4. Si e kalon kohën e lirë, pra çfarë aktivitete bën në shtëpi ose jashtë, kur nuk je duke studiuar për shkollën?

Vlerëso secilin aktivitet me shkallët më poshtë.

| | | | |
|--------|------------|-----------|----------|
| Shpesh | Ndonjëherë | Asnjëherë | Nuk e di |
|--------|------------|-----------|----------|

| |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shikoj TV |
| Lexoj libra jashtëshkollorë |
| Dëgjoj muzikë |
| Luaj në aktivitete sportive (basketboll, futboll,volejball, etj...) |
| Ndjek aktivitete sportive (psh ndjek futboll në stadium, boks, video, ndjek lajme mbi to etj) |
| Merrem me aktivitete që kam pasion / hobi (p.sh muzikë, pikturë, fotografi, balet, etj.) |
| Dal ose kaloj kohë me shokë e shoqe |
| Përdor rrjete sociale (Instagram, TikTok, Snapchat, Facebook, etj.) |
| Përdor internetin për lexime, video dhe kuriozitet të ndryshme |
| Luaj lojëra elektronike në celular ose pajisje të tjera |
| Kaloj kohë me familjen (rri me familjen, vizitoj të afërm, etj) |
| Shkoj jashtë qytetit në fundjavë/udhëtoj |
| Praktikoj aktivitete fetare (shkoj në kishë/xhami etj) |
| Tjetër- shkruaj më poshtë.... |

P5. Cilët janë personazhe të famshëm shqiptarë nga cilado fushë (art, sport, politikë, etj.) që ndjek në rrjetet sociale” Përmend deri në 10 duke specifikuar emër mbiemër ose emrin e artit

Shkruaj emër mbiemër _____

Shkruaj emër mbiemër _____

Shkruaj emër mbiemër _____

Shkruaj emër mbiemër _____

Shkruaj emër mbiemër _____

P6. Sa të rëndësishme janë për ty vlerat e renditura më poshtë?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|---------------------|--------------------|-----------------|----------|
| Shumë e rëndësishme | Disi e rëndësishme | E parëndësishme | Nuk e di |
|---------------------|--------------------|-----------------|----------|

| |
|-------------------------------------------|
| Të paturit rezultate të mira në shkollë |
| Të paturit një rreth të gjerë shoqëror |
| Të qenit të pëlqyer nga shokët dhe shoqet |

| |
|----------------------------------------------|
| Të qenit të bukur |
| Të qenit të fortë |
| Të qenit të sjellshëm |
| Të qenit të ditur dhe të mirëinformuar |
| Të paturit vetëbesim |
| Të qenit të parët / më të mirët |
| Të qenit mbështesës dhe pozitiv me të tjerët |
| Të qenit të suksesshëm |

P7. Sa ndikojnë tek ty dhe zgjedhjet tua aspektet e mëposhtme?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|-------|------|-------|----------|
| Shumë | Disi | Aspak | Nuk e di |
|-------|------|-------|----------|

| |
|---------------------------------|
| Media / Televizioni |
| Rrjetet sociale |
| Kinematografia dhe bota e artit |
| Feja |
| Familja |
| Shoqëria |
| Shkolla / Mësuesit |
| Qeveria |

P8. Në çfarë mase ke besim tek kategoritë e mëposhtme të njerëzve?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|--------------------|----------------|---------------------|----------|
| Kam besim të plotë | Kam disi besim | Nuk kam aspak besim | Nuk e di |
|--------------------|----------------|---------------------|----------|

| |
|----------------------------------------------|
| Prindërit |
| Vëllezërit e motrat |
| Të afërmit / kushërinjtë |
| Shokët |
| Shoqet |
| Mësuesit |
| Psikologët ose punonjësit socialë në shkollë |
| Udhëheqësit fetar (hoxha, prift etj) |

| |
|---------|
| Policët |
| Fqinjët |

P9. A ke vënë re që bashkëmoshatarët e tu të jenë diskriminuar për shkak të faktorëve të renditur më poshtë?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|--------|------------|-----------|----------|
| Shpesh | Ndonjëherë | Asnjëherë | Nuk e di |
|--------|------------|-----------|----------|

| |
|--------------------------------------------------------------------------------|
| Gjinisë (vajzë ose djalë) |
| Statusit ekonomik (të varfër ose të pasur) |
| Përkatësisë fetare (myslimanë, të krishterë, ortodoksë, etj.) |
| Përkatësisë etnike (komuniteti rom, egjiptian, vllah, minoritarë grekë etj.) |
| Pozitës së prindërve (profesioni, pozicioni i punës, etj) |
| Origjinës (qytetare ose fshatare) |
| Aftësi të kufizuara (kufizime fizike, autizmi, sindroma Doën, të verbër, etj.) |

P10. Më poshtë listohen disa shqetësime që të rinjtë mund të përjetojnë. Sa shpesh mendon se i përjetojnë bashkëmoshatarët e tu secilën prej tyre?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|--------|------------|-----------|----------|
| Shpesh | Ndonjëherë | Asnjëherë | Nuk e di |
|--------|------------|-----------|----------|

| |
|-----------------------------------------------------------|
| Vështirësi për të bërë shokë e shoqe |
| Vështirësi në marrëdhëniet me prindërit |
| Vështirësi me rezultatet në shkollë |
| Vështirësi ekonomike në familje |
| Bullizëm në shkollë |
| Ngacmim ose pasiguri fizike në rrugë, lagje, shkollë |
| Duhanpirje |
| Përdorim i alkoolit |
| Përdorim i hashash / bar |
| Përdorim i drogave të rënda (psh kokainë, herorinë, etj.) |
| Përfshirje me grupe kriminale ose të dhunshme |
| Probleme shëndetësore |
| Probleme me ankthin dhe stresin |

P11 Gjatë vitit të fundit , a je përfshirë ti vetë në ndonjë konflikt verbal (debate e grindje me fjalë) me ndonjë prej të mëposhtmeve?

P12. Gjatë vitit të fundit , a je përfshirë ti vetë në ndonjë konflikt fizik me me ndonjë prej të mëposhtmeve?

Zgjidh të gjitha ato alternativa që aplikohen për ju.

| |
|----------------------------------------------------|
| Po, me bashkëmoshatarë të tjerë në shkollë |
| Po, me bashkëmoshatarë të tjere në lagje |
| Po, me mësues ose staf të shkollës |
| Po, në familje me prindërit, vellezërit ose motrat |
| Po, me policinë |
| Po, në raste dhe kushte të tjera |
| Jo, nuk jam përfshirë në konflikt me asnjë |
| Refuzoj të përgjigjem |

P13. Çfarë të frymëzon dhe ju mbush me besim për një të ardhme më të mirë?

Zgjidh të gjitha ato alternativa që të përshtaten.

| |
|-------------------------------------------------------------------|
| Nje sistem i mirë edukimi |
| Mundësi të mira punësimi |
| Të ndërtoj një familje në të ardhmen |
| Mundësia e të bërit biznes |
| Mundësia e të bërit para |
| Mundësi argëtimi dhe kulturë |
| Emancipim shoqëror |
| Kushte më të mira ekonomike në familje |
| Zhvillimi ekonomik i vendit |
| Mbrojtja e mjedisit |
| Zhvillimet teknologjike |
| Drejtësia - të marrësh atë që meriton (në shkollë, në punë, etj.) |
| Qeverisje e mirë dhe në interes të qytetarëve |
| Dashuria |
| Tjetër... |

P14. Duke menduar për pritshmëritë dhe synimet e tua për të ardhmen, sa dakort je me pohimet e mëposhtme?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|------------|------------|----------------|----------|
| Jam dakord | Pjesërisht | Nuk jam dakord | Nuk e di |
|------------|------------|----------------|----------|

| |
|----------------------------------------------------------------------------|
| Unë ndiej frikë dhe pasiguri kur mendoj për të ardhmen time |
| Unë jam optimist/e për të ardhmen time |
| Unë synoj që të ardhmen ta ndërtoj jashtë Shqipërisë |
| Unë ndjehem i/e mbështetur nga familja që të ndërtoj të ardhmen që unë dua |

P15. Çfarë planifikon të bësh në përfundim të shkollës 9-vjeçare?

Zgjidh vetëm një prej alternativave më poshtë.

| |
|------------------------------------------------|
| Do të vazhdoj shkollën e mesme të përgjithshme |
| Do të vazhdoj shkollën e mesme profesionale |
| Nuk do të vazhdoj shkollën |
| Nuk e di |

P16. Sipas mendimit tënd, kategoritë më poshtë janë shembuj pozitivë apo negativë?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| | | | |
|----------------------|----------------------------------------|----------------------|--------------------|
| Më së shumti pozitiv | Mund të jenë edhe pozitiv edhe negativ | Më së shumti negativ | Nuk e di / Neutral |
|----------------------|----------------------------------------|----------------------|--------------------|

| |
|------------------|
| Sportistët |
| Aktorët |
| Këngëtarët |
| Shkrimtarët |
| Politikanët / |
| Udhëheqës fetarë |
| Mësuesit |
| Mjekët |
| Gjyqtarët |
| Zjarrfikësit |
| Policët |

P17. Çfarë mendon për sjelljet e mëposhtme, a janë ato të drejta apo të gabuara?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| Më së shumti sjellje e drejtë | As e drejtë as e gabuar | Më së shumti sjellje e gabuar | Nuk e di |
|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------|
|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------|

| |
|-------------------------------------------------------|
| Të marrësh pjesë në protesta |
| Të pish duhan |
| Të pish alkool |
| Të mbjellësh hashash |
| Të shesësh drogë |
| Të përdorësh drogë |
| Të trafikosh njerëz |
| Të marrësh rryshfet |
| Të vjedhësh paratë ose sendet e dikujt tjetër |
| Të mos paguash taksat |
| Të ndërtosh shtëpi pa leje |
| Të lësh orën e mësimi |
| Të gënjesh mësuesit |
| Të gënjesh prindërit |
| Të mbash armë të ftohta (thikë, dorezë hekuri, etj.) |
| Të mbash armë zjarri (pistoletë, etj.) |
| Të mos i bindesh policisë / të përplasesh me policinë |
| Të diskriminosh për shkak të gjinisë |
| Të ngacmohesh të tjerët (bullizëm) |
| Të përdorësh fjalor banal |
| Të përdorësh dhunë fizike |

P18. Sipas mendimit tënd, cila nga pohime e mëposhtme shpreh më mirë se çfarë është një figurë model ose shembull?

Zgjidh vetëm një prej alternativave më poshtë.

| |
|------------------------------------------------------------------------------------|
| Dikush që ka një personalitet të denjë për t'u imituar |
| Dikush që kërkon të ndihmojë të tjerët dhe bën vepra të mira |
| Dikush që më qëndron pranë dhe kujdeset për mua |
| Dikush që admirohet për veprimet dhe suksesin e arritur |
| Dikush që respektohet nga të tjerët për mendimet, sjelljen dhe kontributin e dhënë |
| Të gjitha sa më sipër |

Asnjë nga më sipër => tjetër, specifiko

P19. Çfarë karakteristikash kanë këta njerëz që i bën ata shembull?

Zgjidh alternativat që mendon se ju përshaten më mirë.

| |
|----------------------------------------------|
| I shërbejnë komunitetit |
| Janë mbështetje për mua |
| Fizikisht të fortë |
| Të guximshëm |
| Punojnë shumë |
| Zotërojnë aftësi të veçanta/ Janë të veçantë |
| Frymëzojnë njerëzit të bëjnë gjëra të mira |
| Kanë një personalitet të bukur |
| Ndihmojnë njerëzit e tjerë |
| Kapërcejnë pengesat |
| Të suksesshëm |
| Të tjerët i respektojnë |
| Kanë shumë para |
| Të famshëm |
| Të ndershëm |
| Shprehin emocione dhe ngrohtësi |
| Kanë pamje të bukur |
| Inteligjentë |
| Kanë rezultate të larta shkollore |
| Tjetër _____ |

P20. Duke menduar për përkufizimin me të cilin je dakord më sipër, cilat janë figurat model për ju?

Zgjidh të gjitha ato alternativa që mendon se vlejnë për ty.

| |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Familjarët tuaj si psh mamaja, babai, gjyshër, motra, vellezër |
| Të tjerë nga rrethi juaj i afërt si psh teze, daja, xhaxha, halla, komshi, etj |
| Shokë, shoqe ose bashkëmoshtarë të tjerë |
| Dikush, profesionist, që njihni në komunitet si p.sh. mësues, mjek, oficer policie, zjarrëfikës, trajner etj |
| Personazhe të famshme nga bota e artit, muzikës, letersisë, media |
| Personazhe të famshme nga bota e sportit |

| |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|
| Personazhe që krijojnë trende në rrjete sociale psh vlogger, blogger |
| Politikanë ose figura të tjera të shtetit (kryeministër, president, kryetar parlamenti etj) |
| Biznesmen ose sipërmarrës të suksesshëm |
| Shkencëtarë të shkencave të ndryshme, shpikës etj |
| Tjetër.... |

P21. Tani shkruaj emrat e figurave model / shembujve që zgjodhët në pyetjen e mësipërme.

Pas emrit të lutem sakto cilët janë ata ose çfarë bëjnë në jetë.

P22. Sa ndikojnë këto figura model tek ty personalisht në aspektet e mëposhtme?

Vlerëso secilën kategori me shkallët më poshtë.

| Shumë | Disi | Aspak | Nuk e di |
|-------|------|-------|----------|
|-------|------|-------|----------|

| |
|--------------------------------------------------------------------------|
| Për stilin e veshjes ose pamjen e jashtme (veshja, flokët, tualeti etj.) |
| Për kujdesin personal (dieta ushqimore, ushtrime fizike, etj.) |
| Për të zgjedhur hobet dhe pasionet që ndjek |
| Për zgjedhjen për shkollimin ose profesionin/zanatin e ardhshëm |
| Për sjelljen me shokët/shoqet, familjen etj |
| Për zgjidhjen e konflikteve me shokët/shoqet, familjen etj |

P23. Cilat duhet të jenë tre prioritetet për të përmirësuar jetën e të rinjve në qytetin e Elbasanit?

Zgjidh deri ne 3 alternativa.

| |
|---------------------------------------------------------------------------|
| Hapësira sportive në qytet |
| Aktivitete kulturore si psh: teatro, kinema, koncerte etj |
| Qendra rinore për t'u mbledhur dhe socializuar |
| Siguri në shkollë dhe rrugë (eliminimi i dhunës, ngacmimeve, etj.) |
| Kushte më të mira në shkollë |
| Parqe dhe hapësira të gjelbra |
| Konkurse ndërmjet shkollave: shkencë, art, letërsi, teknologji, sport etj |
| Qendra kulturore e teknologjie për të rinjtë |
| Tjetër |

Faleminderit për kohën dhe mendimet që ndatë me ne!